

Universiteti i Evropës Juglindore



FAKULTETI JURIDIK

STUDIME POSTDIPLOMIKE TË MASTERIT –DREJTIMI PENAL

TEMA:

“NDIKIMI I FAKTORËVE SUBJEKTIV NËSHFAQJEN E
KRIMINALITETIT NË RAJONIN E KËRÇOVËS NË PERIUDHËN

2009-2015”



Kandidatja: ZANA AHMEDI

ID# 121381

Mentorja: Prof. Dr. Besa Arifi

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA:

KAPITULLI I

1. Hyrja.....	3
1.1. Teoritë e Personalitetit.....	5
1.1.2. Teoria Endokrinologjike mbi kriminalitetin.....	6
1.1.3. Teoria e Intelegjencës.....	6
1.1.4. Teoria e Kromozomeve.....	7
1.1.5. Teoria e Frustracioneve.....	8
1.1.6. Teoria Psiko-Analitike.....	9

KAPITULLI II

2. Përkufizimi dhe ndarja e faktorëve të brendshëm dhe llojet e tyre.....	12
2.2.1. Faktorët subjektiv-emocional.....	13
2.2.2. Karakteri dhe Kriminaliteti.....	14
2.2.3. Temperamenti dhe Kriminaliteti.....	15
2.2.4. Intelegjenca dhe Kriminaliteti.....	18
2.2.5. Motivi dhe Kriminaliteti.....	19
2.2.5. Emocionet dhe Kriminaliteti.....	20
2.2.6. Shprehitë dhe Kriminaliteti.....	21
2.3. Faktorët Biologjik.....	2.3

KAPITULLI III

3.1. Crregullimet mentale.....	24
3.1.1. Neurozat dhe llojet e tyre.....	33
3.1.2. Psikopatitë dhe llojet e tyre.....	40
3.1.3. Psikozat dhe Llojet e tyre.....	42

KAPITULLI IV

4. Analiza komparative dhe empirike e problemit me SHBA (ILLINOIS).....	50
4.1. Përfundim.....	57
4.2. Literatura e shfrytëzuar.....	58

1.HYRJA

Lufta kundër krimit ka filluar që me paraqitjen e njeriut. Që në shoqërinë primitive vërejmë ndërmarrjen e masave kundër krimit I cili ka zgjuar tmerr dhe frikë në të gjithë shoqërinë njerëzore por edhe interes studimi.

Krimi dhe sjelljet e ndryshme kriminale në botën e sotme janë bërë temë e mediave të ndryshme si të shkruara ashtu edhe elektronike , duke përfshirë tema të sjelljeve dhe instikteve më të ulta njerëzore: dhunës ,vrasjeve si dhe sjelljeve të ndryshme patologjike.Gjatë gjithë historisë së shoqërisë njerëzore vëmendje të veçantë ka pasur çështja e formimit të natyrës apo shfaqjes së sjelljes kriminale në qeniet njerzore. Krimi si fenomen i shoqërisë dhe individual dhe shkaqet e tij, kanë qenë përherë objekt interesimi. Si në kohët e hershme ka pasur përpjekje për shpjegimin e paraqitjes së shkaqeve.

Shpjegimet kane qene te ndryshme, shpesh kanë qenë te përcjellura me mistizëm dhe me interpretime irracionale jo të drejta. Qasjet ishin te varura nga shkallet e civilizimit, orientimit ideor, përcaktimit profesionale dhe nivelet shkencor autoritative.¹

Andaj edhe shumë autorë kanë ndërmarrë iniciativë në shpjegimin e faktorëve të brendshëm lidhur me kriminalitetin, si dhe cka e shtyen njeriun të kryej krime, si mund të parandalohet krimi , a ka kriminaliteti ndonjë shkak të veçantë si dhe çka e bën në të vërtetë njeriun kriminel? Në këtë drejtim shpjegim kanë dhënë : Sigmund Frojd, Adlen, Cezario Lambrozo, Ajsenik etj. Për studimin e shkaqeve dhe formave të shfaqjes së kriminalitetit është e domosdoshme të jepen interpretimet psikologjike dhe psikopatologjike. Në preventivën e kriminalitetit është shumë me rëndësi jo vetëm të njihet psikologjia e krimit (kriminalitetit), por edhe ndodhitë e mëvonshme psikike të kryesit të veprës penale dhe të personave tjerë në mjedisin e tij. Kështu, në sjelljen kriminale dalin në sipërfaqe një varg vetish dhe ngjarjesh përjetuese psikike të bashkëpjesëmarrësve në veprën penale, duke filluar nga kryesi deri tek pjesëmarrësit në ato ngjarje. Të gjithë këta pjesëmarrës të këtij veprimi perceptojnë, vërejnë, mendojnë, ndjejnë, mbajnë mend dhe janë të motivuar në mënyra të ndryshme dhe shprehin aftësitë e tyre,

¹ Prof.Dr Ragip Halili, Kriminologjia , 2011

karakterin, temperamentin dhe shumë mirë kontrollojnë tërë këtë përmes personalitetit të tyre. Ndonëse shprehja sëmundje shpirtërore dhe çrregullim psikik me të madhe përdoret në drejtësi dhe kriminalistikë ,megjithatë nuk ekziston definicioni i tyre juridik apo kriminalistik.²

Pra profilizimi i kryesit të krimeve luan një rol të veçantë si në sistemin e drejtësisë kriminale ku mund të zbatohen njohuritë psikologjike rreth sjelljeve njerzore,motivimin dhe patologjitë. Në këtë tezë ne do të shqyrtojmë korelacionin midis çrregullimeve psiqike dhe kriminaliteti , evidencën mos (Modus Operandi System), karakteristikat dhe profilizimi I kryesit të veprës penale,etj.

KAPITULLI I

² Slobodan Lloga, Sudska Psikopatologija, Prishtinë, 2007, fq.7

1.1. TEORITË E PERSONALITETIT

Teoritë e personalitetit kanë disa qëllime kryesore. Njëri është që të organizojë karakteristikat e personalitetit. Teoritë japin një strukturë për të integruar karakteristika si agresiviteti, emocionaliteti, inteligjenca, shoqërueshmëria, ankthi dhe pasiviteti. Teoritë identifikojnë cilat karakteristika janë më të rëndësishmet dhe si organizohen ato në individë të ndryshëm. Kjo na ndihmon të kuptojmë marrëdhëniet midis sjelljeve tona të ndryshme.

Një synim tjetër i teorive të personalitetit është të shpjegojë variabilitetin në personalitet (ndryshimet dhe ngjashmëritë midis individëve). Teoricieni i personalitetit paraqet koncepte që japin faktorët që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit dhe sjelljeve të përditshme të individëve, dhe na ndihmon të kuptojmë pse secili nga ne është i veçantë.

Një synim i tretë i teorive të personalitetit është që të përshkruajnë personalitetin normal dhe të shëndetshëm. Teoricienët e personalitetit kanë studiuar njerëz normalë si dhe njerëz me probleme me shpresën që të përcaktojnë faktorët që kontribuojnë në krijimin e një personaliteti normal.³

Teoritë psikologjike janë të bazuara në karakteristikat psikologjike që përcaktojnë sjelljen e personalitetit) dhe marrëdhëniet e tipareve psikike dhe devijimeve, Sjellja e personalitetit shihet nga pikëpamja psikologjike, por jo përtej kontekstit të faktorëve socialë. "Faktorët e ndryshëm: motivimi, karakteri, emocionet, inteligjenca, tendenca etj. Psikologjia sociale dhe kriminologjia kanë zhvilluar drejtime të tilla si psikoanaliza, teoria e inteligjencës, teoria e perceptimit, teorinë e zhgënjimit dhe të tjerë.

Kemi të pranishme shumë për atë se si zhvillohet personaliteti, çka e motivon, nga e merr energjinë për veprimet etj. Këto teori janë të mendimit se predispozitat biologjike (të trashëguara, fiziologjike, të tjera biologjike) janë faktorë themelorë kriminalistikë. Ne do ti cekim këto lloj teorish:

³ Friedman, Howard; Schustack, Miriam (2016). Personality: Classic theories and modern research. USA: Pearson.

1.1.2. Teoria Endokrinologjike mbi kriminalitetin

Sipas kësaj teorie sjelljet kriminale të disa individëve janë rezultat i mosfunksionimit normal të gjëndrrës endokrine. Shumë dijetarë janë përpjekur që të shpjegojnë sjelljen kriminale të disa individëve lidhur me ekuilibrin e gjëndrrës endokrine. Kjo teori studion sjelljet hormonale dhe sistemet neuroendokrine që ndikojnë në çrregullimin e sjelljes.

Trajtimet endokrinologjike kanë ndikuar pozitivisht në rregullimin e ekuilibrit endokrin.

Individët të cilët kanë probleme me gjëndërrat endokrine i karakterizojnë sjelljet si: xhelozia, zemrimin, të pasionimit, flasin ngadalë, ekzagjerojnë ndjenjat e dashurisë, urrejtjes, ato u referohen subjekteve emocionale, janë agresiv dhe u përgjigjen stimujve të jetës duke mos analizuar veprimet dhe pasojat që mund ti shkaktojnë. Pasojat e këtyre çrregullimeve janë: inteligjencë të ulët, shqetësime dhe instinkte. Çrregullimet endokrine ndikojnë mbi emocionalitetin e personalitetit, dhe lidhja me sjelljen kriminale është më indirekte, është larg nga pasoja e drejtpërdrejtë. Me gjëndrën endokrine shpjegohen deliktet seksuale.

Teoria endokrinologjike është një nga drejtimet e teorisë biologjike që shkakton krimin. Duke prishur shqetësimet në funksionimin e endokrinës "gjëndrat tiroide", hipofizore, adrenale dhe ibidus, japin rezultate negative. Rezultatet e hulumtimit bazohen në pikëpamjen se trazirat mendore, personalitetit, inteligjencën e ulët dhe ndikimet të cilat janë pasojë e këtyre çrregullimeve, shumë autorë sistemin endokrin e perkufizojnë duke marrë atë si shkakun themelor të delikuencës. Todolski pretendon se sa më shumë të bjerë niveli i sheqerit në gjak, aq më e madhe është tendenca për të kryer veprat penale.

1.1.3. Teoria e intelegjencës

Pra kjo teori nisët nga supozimi se Studimi i inteligjencës në hulumtimet kriminologjike ka qenë në zbatim dhe rrodhi në mënyrë të konsiderueshme. Lidhur me këtë teori kemi një ndarje, në të cilën disa studiues përcaktohen se individët me intelegjencë më të ulët kryejnë krime, kurse grupi tjetër i studiuesve ndahen në atë se për të kryer krime të rënda si: krimi i organizuar, larja e parave, vrasje morbide, dhunime etj, si dhe për t'iu shmangur denimit, veprat e të cilëve mbeten të pa evidentuara, nevoitet intelegjencë. Mirëpo keto mund të llogariten vetëm si

hipoteza, pasi që ende nuk mund të gjendet përcaktimi i sakt rreth ndikimit të intelegjencës mbi kriminalitetin.

Ekziston një qasje ndaj teorive psikologjike që sjellin shkakun e delikuencës në lidhje me psikologjinë e intelegjencës së ulët dhe përhapjes. Efikasiteti i intelegjencës çon në shfaqjen e normave shoqërore nga personaliteti. “Pedigre studies” është emri i hulumtimit të marrëdhënies së pranueshmërisë dhe kriminalitetit. Me ndihmën e së cilës u bë testimi gjenetik i kriminelëve dhe trungut të tyre familjar i cili u krye për të konstatuar nëse ekzistonte një bazë në prejardhjen e paraardhësve me IQ të ulët. (Tjetra variantë është ajo me një strukturë të arsimimit të ulët, ky faktor merr programin e intelegjencës së ulët). Të dyja qasjet përpiqen të vërtetojnë se personat me intelegjencë dhe nivel arsimor nën mesataren janë në kundërshtim me personalitete të devijuara në krahasim me njerëzit që janë ndryshe të ndërgjegjeshëm.

1.1.4. Teoria e Kromozomeve

Kriminologët kanë shqyrtuar shumë teori , lidhur me atë se pse një individ bëhet kriminel. Mirëpo me zhvillimet epokale mjeksore, shkencëtarët nga 23 çiftet kromozomike , kanë vërejtur anomali në strukturën e kromozomeve të disa individëve , ku si pasojë shfaqet një kromozom shtesë Y duke pasqyruar XYY, i cili paraqitet te meshkujt të cilët ndryshe quhen “superman”.

Konsiderohet se individët me XYY karakterizohen me agresivitet dhe intelegjencë të ulët. Armatosur me këto arritje shkencore dhe njohuri avokatët mbrojtës kërkuar që këto anomali kromozomike ti përdorin në favor të delikuentit, për rrethana lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit. Pra, Teprica e madhe e Y kromozome krijon një lloj personaliteti të prirur ndaj kriminalitetit. Kjo teori është bazuar në të mësuarit se ka shqetësime në bërthamën e kromozomeve dhe qelizave që përmbajnë gjenet dhe mbajtësit e karakteristikave të trashëguara, dhe prodhojnë sjellje të parregullt sociale. është bazuar në rezultatet e hulumtimit të kryer në të dënuarit dhe që tregojnë se disa dallime në mesin e kriminelëve shumë më shpesh XYY kombinimet e kromozomeve dhe jo popullatës normale. edhe pse e kanë zhvilluar hipotezën se kromozomet e tepërta Y në lidhje me sjelljen kriminale, veçanërisht të dhunshme. Jacobs ka sugjeruar se njerëzit me sindrom XYY kanë më të lartë shkallën e agresionit në vend të njerëzve

normalë XY. Sigurisht veçantë e cek teoria biologjike, pra e shpjegon se teprica e madhe e hromozmeve Y krijon një lloj personaliteti kombinim të prirur ndaj kriminalitetit . Edhe pse XYY kromozom kanë kromozome të veçantë tek meshkujt dhe kromozomeve XXY në gratë janë konsideruar kriminogjenik. Ky kombinim është kështu si vijon:

XYY në meshkuj dhe femra

XXY në gratë -konsiderohen kriminalistike- inkurajon një lloj të caktuar krimi – P.sh marrëdhënie seksuale, grindje, vrasje, dhe në prostitucion.

Teoria bazë është se:

- Një nga 1000 burra ka aberacion kromozomal XYY
- Njeriu XYY është më i ndjeshëm ndaj sjelljes kriminale se sa një njeri XY
- Njeriu XYY është më pak inteligjent se një njeri XY
- Pasi që ka më shumë XYY burra në burgje në krahasim me burrat XY, të cilat janë liruar, ky çrregullim hormonal është faktori kryesor, për agresivitetin dhe dhunën e një personi të tillë.

Megjithtë duhet marrë parasysh edhe faktin se shumë individë që vuajnë nga kromozomi shtesë, jetojnë një jetë normale duke respektuar ligjin.⁴

1.1.5. Teoria e Frustracioneve

Sipas kësaj teorie ,sjelljen kriminale arrin ta shpjegojë në bazë të asaj se disa individë nuk arrijnë ti kënaqin kërkesat e tyre dhe për këtë arsye nxitet agresioni dhe shkaktohen frustrime psikike. Këto individë ndihen inferior dhe të dëshpëruar. Frustrimet ju paraqitën që në fëmijëri, duke u rritur në dissharmoni familjare.

Teoria e frustracioneve interpretohet si sjellje delikuate duke paraqitur faktorët e pamundësisë së përshtatjes së personalitetit ndaj kushteve sociale reale, duke shkelur qëllimet e individëve dhe interesat e komunitetit. Psikoanalistët bazohen në premisën se çdo qenie njerëzore ka një prirje kriminalistike dhe se ata nuk janë ai që pohon se njeriu është, kjo shpjegohet nga pasoja e veprimit të përhershëm të faktorëve frustrues në

⁴ Jean Pinatel, Hromozomska Teorija , Journees Internacionales De Criminologie Clinique, Comparee, 1973

personalitetin në zhvillimin e tij, ku shfaqen zhgënjim, ndryshime emocionale dhe shqetësime në funksionet psikike të manifestuara . Individët të cilët e kanë të vështirë të përshtaten në ambiente të reja jetsore , dmth fshat- qytet , ose nga qytete me te vogla në metropole më të mëdha , nga vetë ndryshimi i ambientit jetsorë, kryejë veprime kriminale.

1.1.6. Teoria Psikonalitike

Pika fillestare për shpjegimin e devijimit të gjendjes psikologjike të personalitetit është në sferën e forcës dhe impulseve seksuale të pandërgjegjshme, nëndërgjegjshmen, të shtypur. Në të njëjtën mënyrë fillon nga teza se gjithçka që i ndodh gëzimit dhe ëndrrave të njeriut lind nga varfëria, pasojë e një ngjarjeje në fëmijërinë e hershme, e cila lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e seksualitetit në kuptimin më të përgjithshëm të psikologjisë kriminale të teorisë në elementet e instinktit, veçanërisht të instinktit të vdekjes . Kjo është një manifestim i tendencës së njeriut ndaj shkatërrimit, agresionit dhe formave të tjera të dhunës. delikti psikoanalitik është një produkt, ose pasojë e një dëshire të shtypur në nënvetëdije, sepse shkëputja bie ndesh me motivet e fshehura dhe dëshirat ku prodhojnë konflikte të brendshme.⁵

Si themelues i teorisë së psikoanalizës , në veprën e tij “Psikoanaliza” Sigmund Frojd, sjelljet deviante, si dhe çdo sjellje tjetër të individit e konsideron se buron nga fëmijëria, dmth në kalimin me sukses të fazave:

- **Faza Orale- (ku fëmija kënaqsinë e arrinë përmes gojës,)**
- b) Faza Anale (në të cilën fazë fëmija kënaqsinë e arrinë përmes kryerjes së nevojës)**
- c) Faza Falus (e cila te fëmijët karakterizohet me luajtjen e organit seksual)**
- d) Faza Latente (në të cilën individi kënaqësinë e arrinë me anë të fjetjes dmth kënaqsisë seksuale.)**

Sipas Frojdit, mos kalimi me sukses i këtyre fazave ,karakterizohet me sjellje devijante.

⁵ Daniel Cvijic, I Pojam i Svatanja Kriminologije, academia.eu- Published Doc. fq.9

Frojdi interpreton se sjelljet devijante të individit , burojnë nga nënvetëdija, ku si pasojë e mospërputhjes së komponenteve : ID, EGO dhe SUPEREGO pason agresiviteti, zemrimi, ankthi nga i cili si rezultat vjen deri tek sjellja kriminale.

Sipas Sigmund Frojdi funksionimi i personalitetit gjendet tek instiktet.

Instiktet janë bazë e konflikteve, kurse konfliktet janë shkas për çrregullime të ndryshme në jetë.

Duke trajtuar pacientët e vet nëpërmjet hipnozës Frojdi ka vërejtur se tek pacientët e tij ekziston “vetëdija” dhe “pavetëdija”. Ai ka konstatuar se tek të gjithë pacientët ekziston ndjenja e fortë e fajit.

Këtë e sqaron nëpërmjet :

ID (AJO)- të pavetëdijshmen

EGO (UNË)- të vetëdijshmen

SUPER EGO (MBI UNË) –që formohet nga rrethi , fazat e zhvillimit , etj.

Ngjashëm, ekzistojnë pikëpamje ku faktorët e krimit interpretohen si disavantazhet e marrëdhënies midis komponentëve funksionale:

ID "pjesa e pavetëdijshme e strukturës psikike dhe bën pjesë në personalitetin e afrodiziakëve ,

EGO "Reflekton mendimin, perceptimin, fjalimin, të mësuarit, kujtesën, shpërndarjen, motorin, veprimin dhe ngjashëm.

SUPER EGO ndërjegje, i referohet kërkesave morale, normës së shoqërisë dhe sociale. Id, Ego dhe Superego nuk janë të ndara, por janë në një marrëdhënie dinamike.

Poashtu duhet të përmendet se Frojdi, lidhur me çrregullimet mentale dhe emocionale i cek edhe dy komplekse:

a) Kompleksi i Edipit – e cila buron nga mitologjia greke, e në të cilën thuhet se mbreti Edip, është dashuruar në të ëmën e tij, dhe duke e parë babanë e tij si rival , ai e vret atë me qëllim që të martohet me të ëmën. Ky kompleks tregon se djali nuk e ka kaluar siç duhet fazën fallike dhe atë të ID-it, rrjedhje e së cilës i kemi : shqetësimet nervore, smundjet dhe çrregullimet.

b) Kompleksi i Elektrës - është analog me kompleksin e Edipit, ku sipas teorisë Frojdiane, vajza e vogël ndjen infiroritë ngase nuk ka organin gjenital të meshkujve , dhe për këtë e fajson nënën e saj. Nga shkakut e këtyre deformimeve seksuale , të cilat kalojnë nga vetëdija në nënvetëdije vjen deri tek veprimet dhe sjelljet deviante.

KAPITULLI II

2. Përkufizimi dhe ndarja e faktorëve të brendshëm

Strukturën e personalitetit e përbëjnë veti dhe karakteristika të ndryshme të cilat ndryshe quhen edhe tipare themelore ose esenciale.

Këto janë: Vetitë afektive, dispozicionet motivuese, aftësia, faktorët konjitiv, dispozicionet social-shoqërore etj.

Komponenta e njohjes së personalitetit ka rëndësi mjaft të madhe pasi dinamikën e personalitetit e përbëjnë faktorët e brendshëm .

Shumë autorë kanë pohuar se në ndikimin e kryerjes së veprave penale apo krimeve ndikojnë: frika, cënimi moral , fizik, cënimi i të mirave materiale etj.

Në kohën në të cilën jetojmë , jemi jashtë mase të ekspozuar në krim.

Ndjenjat , motivet mund të jenë nga më të ndryshmet mirëpo disa autorë konstatojnë se krimi buron nga nënvetëdija ,ku secili nga ne mund të jetë kriminel potencial.

Shumë individë kryejnë krime për tu identifikuar me kryesin : Tentimi për vrasjen e Presidentit Ronald Reagan, ku kryesi jostabil me shenja të depresionit fiksoet pas vrasjes së ish Presidentit të ndjerë Amerikan John Kennedy ,rast të cilin e imiton në kryerjen e vrasjes së Presidentit Ronald Reagan e cila rezulton në tentativë.

Nga analizat dhe kërkimet njëri nga faktorët të cilët ndikojnë në kryerjen e krimeve ceket edhe kënaja e epsheve (çrregullim).

Në rastet e tilla kriminelit duhet të observohet , duhet të studiohet nga ekspertë klinik ku do të ballafaqohen sy në sy me kryesin dhe do të krijojnë profilin e kriminelit , nga ana e karakteristikave psikike (psikiatrike) u analizohet jeta që nga fëmijëria e hershme e deri tek momenti i kryerjes së krimit , mënyra në të cilën e ka kryer krimin etj.

Vetitë psikike shumëherë janë komponentë determinues në momentin e kryerjes së veprës penale Si faktorë të cilët ceken të cilat ndikojnë në kryerjen e krimeve janë:

2.1. Faktorët subjektiv-emocional

Faktorët subjektiv emocional të sjelljes devijante ndahen në : **Faktorë psikik dhe Faktorë Biologjik**

Sipas Prof.Dr. Ragip Halili Personaliteti i njeriut është i ndërtuar nga baza biologjike dhe psikike, këto janë dy komponentë të pandara që ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e personalitetit normal të personit. Njeriu si personalitet ka në strukturë të veçantë psikike e cila që nga lindja e deri në vdekje ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij. Në hulumtimet dhe kërkimet shkencore theksohet, se shumë rrethana që kanë të bëjnë me sjelljet dhe veprimet e disa individëve, nuk mund të shpjegohen pa analizuar individin dhe botën e tij psikike.

Kur flitet për faktorët psikik, konkretisht mendohet për personalitetin e njeriut.

Shumë herë këto faktorë rezultojnë vendimtarë në jetën e njeriut. Personaliteti dallon njëri-tjetri, ai ndryshon nëpër fazat e jetës. Personaliteti përfshin vetitë dhe karakteristikat e njeriut, të cilin e bëjnë unik dhe të dallohet nga të tjerët. Përkufizimet e personalitetit përfshijnë: vlerat, mënyrat e përshtatjes etj. Si faktorë psikik mund të cekën : Temperamenti, Karakteri, Intelegjenca, Emocionet, shprehitë, motivet etj. Personaliteti është faktorë kyç për dallimin e kriminelit nga jokrimineli, andaj me kujdes duhet analizuar se çfarë e bën një kriminel "kriminel" duke identifikuar tiparet e ndryshme të personalitetit. Në analizat e bera në burgun e Bardovcit , ku vuajnë dënimin persona me smundje psikike disa të dënuar treguan intelegjencë të lartë, vetbesim dhe spontanitet por me emocione më pak të qëndrueshme.

Si përfundim : A janë kriminelët të lindur apo të bërë? Kjo pyetje ka befasuar psikologë, sociologë dhe kriminologë për shumë vite, dhe janë bërë përpjekje për të vendosur natyrën e kriminalitetit. Argumenti i lindur ose i bërë, i njohur si "natyra kundrejt edukimit", ngre pyetjen nëse kriminaliteti është për shkak të faktorëve gjenetikë dhe për këtë arsye është e pashmangshme, ose nëse është produkt i mjedisit shoqëror, situacional, mjedisor dhe faktorë të tjerë të jashtëm.⁶

Tiparet e temperamentit dhe të karakterit janë vlerësuar prej disa pacientësh psikiatrik, me ose pa çrregullime të personalitetit dhe gjendje të ndryshme.

⁶ Personality Correlates of criminals: A comparative study between normal controls and criminals, Sudhinta Sinha, 2016, Article

Rezultatet: Çdo nëntipi i çrregullimit të personalitetit krijoi një kombinim unik të korrelacioneve me katër tiparet e temperamentit.

Përfundim: Tiparet e karaktereve përdoren për të diagnostikuar praninë dhe ashpërsinë e çrregullimit të personalitetit, ndërsa tiparet e temperamentit përdoren për diagnozën diferenciale. Dallimi midis temperamentit dhe karakterit ofron një bazë tërheqëse teorike për postulatet e etiologjike dhe trajtimin e çrregullimit të personalitetit.⁷

2.2.1. Karakteri dhe Kriminaliteti

Karakteri është respekt i parimeve të caktuara morale.⁸

Karakteri konsiderohet si vullë e personalitetit të njeriut i cili karakterizohet me vullnetin, qëndrueshmërinë stabilitetin vetëbesimin dhe vendosshmërinë.

Këto individë i mëson që nga fëmijëria nëpërmjet familjes dhe gjatë rritjes me edukimin në shkollë dhe rrethin ku jeton. Nëse këto procese nga fëmijëria e deri në formimin e personalitetit arrijnë sukses atëherë arrijnë në virtyte pozitive. Si tipare të karakterit cekën: ndërgjegjësja, frika vetëkritika etj.

Kahjen në kryerjen e kriminalitetit shumica e drejtojnë tek karakteri.

Pra karakteri është kompleks i vetive personale vendosmërisë etj, të cilat e bëjnë të dallojë çdo person që nga lindja me personat tjerë..

Karakteri përveç vetive morale si vetëdënia, modestia, përfshinë edhe forcën.

Në vështrimin kriminalistik ku kemi të bëjmë me karakterin duhet të ceket se personat të cilët nuk dinë se si të mbizotërojnë ndikimet negative qofshin si faktorë të jashtëm apo të mbrendshëm, kryejnë veprime të ndryshme kriminale dhe sjellje devijante të cilat janë veprime

⁷ Individit dhe Personalitetit, Gazeta Mapo, 2016

⁸ Sllobodan Lloga, Psikopatologjia Gjyqësore, Prishtinë, 2007, fq42

egoiste agresive,impulsive. Nëpërmjet karakterit arrihet të përpilohet profili i kriminelit andaj është e domosdoshme që të njihet mirë karakteri.

2.2.2. Temperamenti dhe Kriminaliteti

Temperamenti gjegjësisht është veti e lindur i cili karakterizohet me ragimin e emocioneve , forcën, si dhe zgjatjen e ndjenjave qoftë ato të mira apo ato zymta. Shpesh thuhet se çdo individ është unik. Këto dallime individuale tashmë shfaqen në fillim të zhvillimit (de Pauë & Mervielde, 2010): disa fëmijë po largohen, ndërsa të tjerët qëndrojnë në sfond; disa fëmijë reagojnë në mënyrë agresive, ndërsa të tjerët reagojnë më butë. Këto karakteristika individuale të njerëzve mund të përshkruhen gjerësisht si 'temperament'. Që nga vitet 1960, studiuesit kanë studiuar strukturën e temperamentit dhe kuptimi i ndryshimeve temperamentale tek fëmijët. Megjithatë, ende nuk ka shumë konsensus në lidhje me ndërtimin e temperamentit. Diskutimi ekziston në modelin që kap më së miri kyçin në aspektet e temperamentit dhe mënyra më e mirë për ta matur atë. Shumë teori të temperamentit kanë qenë të propozuara dhe madje edhe sot, ende duhet të arrihet konsensusi për një përkufizim të saktë të temperamentit (dePauë & Mervielde, 2010). Shumë studiues janë pyetur nëse sjellja antisociale në adoleshentët dhe të rriturit mund të gjurmohen në fëmijëri, dhe kështu, mund të lidhen me stilet e temperamentit ose tiparet.Hulumtimet me të vërtetë vërtetuan se disa stile të temperamentit dhe shumë tipare temperamentuese janë lidhur me zhvillimin e sjelljeve të mëvonshme antisociale.Pra, temperamentit përshkruan profilin e personit, të energjisë emocionale dhe mënyrën e reagimit ndaj subjektit. Dmth temperamentit nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit apo ngacmimeve të jashtme dhe ngjarjeve që e rrethojnë .

Kemi këto lloje të temperamentit:

Temperamenti Kolerik

Temperamenti Sanguinik
Temperamenti Flegmatik dhe
Temperamenti Melankolik

Personat me Temperamenti Kolerik – shqetësohen shumë shpejtë dhe për imtësira ato shpeshherë bien në konflikt me persona të tjerë . Këto persona shpejtë e ndryshojnë disponimin dhe e shprehin haptas. Ato nuk janë stabil dhe kanë sjellje devijante. Këto persona kanë veprime të shpejta dhe të forta , emocione të intenzitetit të lartë , janë emocionalisht të ndjeshëm , kanë reaksione afektive dhe veprime agresive. Ato eksplodojnë gjatë reaksioneve.

Personat me Temperament Sanguinik- Këto persona kryejnë vepra në afekt, ngase në moment nuk mund të gjykojnë dhe logjikojnë (kanë hapsirë të ngushtë në atë moment). Këtyre personave shpejtë u ndryshon disponimi, reagojnë me vrull, mirëpo u kalon shpejtë.Këto persona shpjegohen si tipa në gjendje psiqike të veçantë ngase veprimet i kanë të shpejta dhe të forta ,emocione të intenzitetit të lartë , prandaj ato janë kah të reaksioneve afektive dhe veprime agresive. Këto persona shpejtë mendojnë dhe shpejtë sjellin vendime.

Personat me Temperament Melankolik- Rrallë herë reagojnë, por kur reagojnë ato reagime janë të gjata dhe intensive.
Janë tipa të mbyllur në vetvëte , preken lehtë,, çrregullimin emocional e kanë të fuqishëm ,janë të pikëlluar , të pavendosur, dhe reagojnë me vonesë. Këto tipa hasen shpesh dhe krimet që i kryejnë janë nga xhelozia dhe rivaliteti.

Personat me Temperament Flegmatik- Janë më stabil dhe më të matur ndaj rrethit shoqërorë dhe kriminalitetit. Personat me temperament flegmatik rrallëherë shqetësohen . Ato hasen shpesh në jetën e përditshme dhe emocionet i kanë të dobëta. Janë persona që nuk nxitojnë në veprime . Janë stabil dhe reagojnë qetë dhe janë të ngadalshëm,. Këto persona mund të paraqiten si recidivistë dhe veprat penale dhe krimet i kryejnë me paramendim.

2.2.3. Integjenca dhe Kriminaliteti

Intelegjenca është aftësi e individit për adaptuar në kushtet e reja të jetesës.⁹Me intelegjencë kuptojmë shkathhtësinë e trurit, kapacitetin e të menduarit dhe vepruarit.

Kërkimet e shumta kanë demonstruar se mesatarja e IQ tek kriminelët është 90-93, kurse tek popullata jo kriminale , mesatarja e IQ është 100. Në kriminologji IQ ka rëndësi ngase ndikon në zgjedhjen e veprimeve dhe pasojave.

Duhet cekur se intelegjenca mund të jetë nën ndikimin e faktorëve të trashëguara dhe nën ndikimin e mjedisit.

Sipas të dhënave Intelegjenca tek personat zhvillohet deri në moshën 20 vjeçare , por ka që mendojnë se zhvillohet edhe më herët.

Nga këto rezultate del në pah se njerzit që kryejnë krime kanë IQ më të ulët , mirëpo kjo nuk duhet të merret e sakt , pasi që gjatë hulumtimeve të bëra kanë dalë rezultate në të cilat njerëzit me IQ të lartë kanë kryer krime shumë të rënda dhe ende sot e kësaj dite nuk janë zbuluar.

Ndarja e intelegjencës, Tabela si vijon:	
Intelegjencë shumë të lartë	120
IQ të lartë	111-120
IQ mesatare	90-110
IQ nën meatare	70-89

Duke analizuar të burgosurit si dhe ato të cilët I janë shmangur ligjit duhet të ceket se intelegjenca duhet të merret me rezervë , pasi që ajo nuk është tregues përfundimtar për përcaktimin e fajsisë apo pafajsisë tek kriminelët.

çrregullimet e intelegjencës ndahen :

retardim mental dhe # **demencion.**

Tek retardimi mental bëjnë pjesë : ngecja mendore dhe ngecja shpirtërore.

Tek demencioni bëjnë pjesë : Ngecja e lehtë shpirtërore , Ngecja mesatare shpirtërore, Ngecja e rëndë shpirtërore dhe Ngecja e thellë shpirtërore.¹⁰

Nga kjo rezulton se sa më e rëndë smundja dhe ngecja , aq më i rëndë krimi dhe veprimi do të jenë.

⁹ Slllobodan Lloga, Psikopatologjia Gjyqsore fq. 17 , Prishtinë, 2007

¹⁰ Slllobodan Lloga, Psikopatologjia Gjyqsore, Prishtinë, 2007, fq 19

2.2.4.Motivi dhe Kriminaliteti

Motivet janë fuqi shtytëse apo nxitëse të cilat individin e udhëheqin në aktivitetin e tij jetësorë. ato përbëhen prej elementeve të vetëdijes dhe vullnetit.

Mund të jenë : Të lindura dhe të fituara gjatë zhvillimit të individit.

Individët nëqoftë se nuk arrijnë të kontrollojnë dëshirat dhe nevojat e tyre kryejnë më shumë krime.

Motivi edhe pse lëviz aktivitetin e njeriut , shpeshëherë ndodh që individi për sukseset e veta , për afirmim, për begati materiale e morale ndodh që të kryej krime. Kur njeriu nuk ndjen siguri dhe stabilitet problemet shtohen pasi që këto nevoja nuk mund të plotësohen dhe shfaqet agresiviteti , anksoza, të cilët ndikojnë në marrjen e vendimeve të gabuara tek individët e caktuar.

Mirëpo, motivet si faktor subjektiv luajnë rol të madh në paraqitjen e sjelljeve delikuate. Është e domosdoshme që këto të shpjegohen dhe interpretohen ,ngase pa shpjegimin dhe analizimin e tyre nuk mund të njihet dhe kuptohet kriminaliteti.

Veprimet delikuate janë veprime të vetëdijshme ngase personi i cili kryen vepra penale para kryerjes sjell vendimin. Pra para se të marrë vendimin për kryerje të veprës penale , veprimet zgjohen , veprime të cilat janë të lidhura me interes , qëllimet,nevojat , emocionet si dhe nevojat personale.

Motivet janë gjithonë të lidhura për qëllime të caktuara qoftë ato dëshira apo interesa të ndryshme, andaj kanë rëndësi të madhe në ndikimin e kryesit.

Këto kryes kanë impuls të karakterit dinamik të cilat i drejtojnë drejt aktivitetit të tyre kah një rrugë e caktuar.

Në kriminalistikë tek kryesi nëse nuk ekziston motivi ose nuk është i qartë atëherë shërben si indikatorë i smundjeve psiqike. Pra kjo shërben si udhërrëfyes I dallimit midis smundjes psiqike dhe njeriut të shëndoshë.

Sipas Millatoviq 1976, fq 347 kemi 3 lloje të motiveve

Motive Instiktive

Motive të Motivuar

Motive Interaksioniste

Motivet instiktive vijnë nga brendësia e personit delikuent, ato janë të lindura dhe që në vegjëli janë në prirje për të kryer vepra penale.

Në thelb janë të meta psiko-analitike në të cilën u kufizohet të menduarit në sferën e motiveve.

Motivet e motivuara paraqiten si rezultat i nxitjes për aksion të shtytura nga instiktet. Edhe ky proces është i orientuar psiho-analitikisht.

Pikëpamja Instiktiviste dhe motivimi fillojnë nga nënndërgjegja e impulseve , që konfirmon orientimin e tyre psikoanalitik.

Motivet interaksioniste fillojnë nga pikëpamja e marrëdhënieve të njeriut me personat tjerë në mjedisin shoqërorë e cila është baza për dinamikën e sjelljes individuale dhe dukshëm nga ato të mëparshme sepse ajo ka një qasje sociale, sociologjike dhe psikologjike që është burimi i motiveve në vetë shoqërinë.

2.2.5. Emocionet dhe Kriminaliteti

Emocionet përkufizohen si përjetime të individit ndaj asaj që ai di dhe vepron. Ato janë nxitje fiziologjike që e shtyejnë individin të veprojë.

Emocionet nvaren nga rrethanat në të cilat gjendemi dhe që e kanë shkaktuar atë.

Ato mund të jenë stabile dhe jostabile . Emocionet jostabile çojnë në gjendje individët të kryejnë aty për aty veprimin pa menduar pasojën.

Emocionet ndahen në:

Elementare, ku kemi : shprehjen e brengosjes, kënaqësisë, moskënaqësisë etj dhe

Emocione komplekse – këtu kemi përjetimet më të thella të individit , këto shprehin ndryshim me intenzitet më të madh.

Emocionet mund të trashëgohen nga paraardhësit ose të krijohen gjatë rritjes, zhvillimit dhe formimit të personalitetit të individit.

Stabiliteti emocional luan rol të rëndësishëm në përcaktimin e delikuentit .

Tek personat me çrregullime vërehen këto shenja : skuqja, dridhja e duarve , marramendja, etj.

Këto persona janë në gjendje afektive sjellje e cila shtyen drejt kryerjes së krimit, prandaj emocionet duhet të analizohen si një ndër faktorët që ndikojnë në sjelljen kriminale.

Personat emocionalisht jostabil kanë prirje suicidibile.

Pasqyrim I rastit:

Vajza 22 vjeçare nga qyteti i Kërçovës me iniciale C.S e cila ishte shëruar për 10 vite me rradhë nga çrregullimi bipolar , e zbuluan që vuante nga jostabilitet emocional më 22.10.2009 dhe pranonte terapi. Gjatë qëndrimit në Pavionin psikiatrik për Psikoza dhe Neuroza në Shkup ajo në bashkëbisedim më zbuloi se shpesh kishte tentuar të vetëvritej , kishte mendime suicide dhe disa herë kishte rënë në konflikte publike dhe kishte prishur rendin publik.

2.2.6. Shprehitë dhe Kriminaliteti

Shprehitë zhvillohen dhe formohen që në fëmijëri , në ambientin familjarë , në shkollë dhe ndikim ka edhe rrethi shoqërorë.

‘Nëse në një ambient familjen, shkollën rrethin që jeton një individ mbizotëron dhuna , mashtrimi, droga , vjedhja etj , atëherë ky individ që është rritur dhe edukuar në atë frymë do vazhdojë të njejtën rrugë.

Shprehitë kanë rëndësi në njohjen e disa formave të kriminalitetit.

Kriminelët nga shprehitë Eriko Ferri i ndanë në 3 nëngrupe : kriminelë të sëmurë mentalisht , me të meta morale dhe fizike dhe në kriminelë të papërmirsueshëm, ndërsa kriminelët e rastit i ndanë në kriminelë përshkak të ndikimeve të jashtme dhe për shkak të ndikimeve dhe pasioneve të brendshme.¹¹ Sipas Raffaello Garafalo kriminalitet natyror konsiderohen ato sjellje dhe vepra që rrezikojnë dhe çenojnë ndjenjat e përgjithshme altruiste dhe fisnike të botës së civilizuar. Këto vepra nga vetë brendia e tyre janë kundër natyrës së njëzimit e jo pse ligjvënësi i ka caktuar me ligj si vepra penale të tilla janë veprat penale kundër jetës, nderit, pronës etj.¹²

¹¹ Drita Shala Punim Shkencor, Kriminologia, 2013, fq.2

¹² Po aty

Këto persona nuk kanë anomali fizike e biologjike, kanë karakter labil dhe veprimet i kryejnë si rezultat i mungesës së edukatës, gjatë zhvillimit, ndikimit të rrethit shoqërorë, ku dukshëm ndikojnë tek individit i cili pastaj kryen delikte seksuale, vjedhje, mashtrime për të cilat ai individ pastaj nuk ndjen përgjegjësi e as grryerje të ndërgjegjes e as pendesë.

2.3. FAKTORËT BIOLOGJIK DHE KRIMINALITETI

Ky seksion fokusohet drejtpërdrejt në rolin që karakteristikat biologjike luajnë në origjinën e sjelljes kriminale, të pavarur nga çdo shoqatë me pamjen fizike ose mungesën mendore. Disa nga këto karakteristika biologjike janë gjenetike dhe të trashëguara, dmth ato janë rezultat i gjeneve që individët marrin nga prindërit e tyre në kohën e konceptimit. Sipas Prof. Dr. Ragip Halili në hulumtimet mbi sjelljet deviante të personit theksohet se përveç vetive dhe cilësive psikike që ndikojnë në paraqitjen e sjelljeve kriminale, rol dhe rëndësi të veçantë në paraqitjen e delikuentës nga të miturit kanë edhe vetit dhe bazat biologjike. Rezultatet e tjera nga mutacionet gjenetike që ndodhin në kohën e konceptimit ose zhvillohen ndërsa fetusi është në mitër. Këto karakteristika biologjike janë gjenetike, por jo të trashëguara. Ende të tjerët mund të zhvillohen si rezultat i mjedisit të personit, të tilla si nga lëndimi ose dieta joadekuate (Bulimia , Anoreksia). Këto karakteristika biologjike nuk janë as gjenetike as të trashëguara.

Teoritë e hershme biologjike në kriminologji morën mendimin se struktura përcakton funksionin - domethënë, individët sillen ndryshe për shkak të faktit themelor se ato janë disi me struktur ndryshe. Këto teori priren të përqëndrohen fort në karakteristikat e trashëguara. Teoritë moderne biologjike në kriminologji, në të kundërt, shqyrtojnë të gjithë gamën e karakteristikave biologjike, duke përfshirë ato që rezultojnë nga defekte gjenetike (dhe kështu nuk trashëgohen) dhe ato që janë të shkaktuara nga mjedisi. Përveç kësaj, teoritë moderne nuk sugjerojnë se karakteristikat biologjike direkt "shkaktojnë" krimin. Në vend të kësaj, ata argumentojnë se disa kushte biologjike rrisin gjasat që një individ do të përfshihet në modele sjelljeje të pakapshme (p.sh. sjellje të dhunshme ose antisociale) dhe se këto sjellje mund të përfshijnë veprime që përcaktohen ligjërisht si kriminale. Së fundi, teoritë moderne përqëndrohen gjithnjë e më shumë në bashkëveprimin midis karakteristikave biologjike dhe mjedisit social, në vend që të kërkojnë vetëm efektet e vetë biologjisë. Këto quhen teori biosociale të krimit, dhe shumica e

kriminologëve biologjikë e pranojnë se kjo është ajo ku fusha duhet të shkojë në të ardhmen.¹³ Për ta përmbledhur, mund të themi se (1) sjellja penale, sidomos sjellja kronike kriminale, duket të jetë e predispozuar pjesërisht gjenetiksht; (2) Një detyrë e rëndësishme në këtë pikë është të përpiqet të përcaktojë faktorët biologjikë që i bëjnë njerëzit të predispozuar ndaj krimit; dhe (3) Ne kemi lidhur disa hapa paraprakë që merren në studimin e sistemit nervor autonom si një bazë e mundshme e trashëguar biologjike për dështimin e forcave normale të të mësuarit shoqëror në pengimin e sjelljes kriminale. Ne diskutuam qëndrueshmërinë e pohimit të përgjegjësive penale ndaj individëve, sjellja kriminale e të cilëve ka një etiologji pjesërisht gjenetike. Por kjo konsideratë e veçantë duket se i vendos faktorët biologjikë veçse si në një kategori të veçantë shkakësore. Në fakt, faktorët gjenetik, fiziologjik dhe biokimik janë agjentë shkaktarë në të njëjtin kuptim si familja, klasa sociale, apo faktorët e rrethit. Sigurisht, sjellja kriminale (si çdo sjellje tjetër) duhet të shkaktohet; një klas e variablave shkakësore është kategoria biologjike. Doktrina ligjore e përgjegjësive nuk sfidohet duke identifikuar faktorët biologjikë si një pjesë të përcaktimit të krimit më shumë se sa nga gjetjet e shkakësive sociale. Vetëm në rastet kur faktorët jonormalë biologjikë janë ndikime jashtëzakonisht të fuqishme mund të sfidohen përgjegjësitë. Raste të tilla do të jenë mjaft të rralla.¹⁴

KAPITULLI III

3.1. Çrregullimet mentale dhe Kriminaliteti

«Çrregullimet mendore prekin qindra milionë njerëz në çdo pjesë të botës dhe ndikojnë në jetën

¹³ GPR 200 Criminology and Penology Handout No.3, fq. 1, Rose J. Ayugi, 2007

¹⁴ Po aty

e të afërmive. Një në katër veta preket nga ndonjë çrregullim mendor në një moment të jetës. Depresioni është kontribuesi kryesor i paaftësisë në mbarë botën. Skizofrenia dhe çrregullimi bipolar janë ndër çrregullimet më të rënda që shkaktojnë paaftësi. . . . Ndonëse prekin një numër marramendës njerëzish, çrregullimet mendore mbahen fshehur, lihen pas dore dhe paragjykoen.»—Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh).

Sipas OBSh-së, mjaft njerëz me sëmundje mendore ngurrojnë të kërkojnë trajtim mjekësor për shkak të stigmës ose damkës si të sëmurë mendorë.

Në pikëpamjen mjekësore, specialistët i përkufizojnë çrregullimet mendore si mosfunksionim serioz në mënyrën e të menduarit të dikujt, në kontrollimin e ndjenjave dhe në sjellje. Kjo gjendje shpesh e pengon personin në marrëdhëniet me të tjerët dhe të përballojë sfidat e jetës. Shkalla e simptomave mund të ndryshojë për nga kohëzgjatja dhe intensiteti, në varësi të individit dhe të sëmundjes specifike e rrethanave. Mund të preken njerëz të çdo gjinie, moshe, kulture, race, feje ose arsimimi dhe gjendjeje ekonomike. Çrregullimet e shëndetit mendor nuk shkaktohen nga ndonjë dobësi e personit ose nga ndonjë e metë karakteri. Me anë të kujdesit të duhur shëndetësor, individët mund të kurohen e të bëjnë jetë normale e me kuptim.¹⁵ Me miliona njerëz në botë vuajnë nga çrregullimet mendore dhe numri i tyre sa që vjen dhe shtohet. Këto çrregullime prekin këdo pa marrë parasyshë moshën gjininë apo vendin prej nga vijnë ato njerëz. Çrregullimet mendore paraqesin mosfunksionim serioz në mënyrën e të menduarit të dikujt dhe mos kontrollim të emocioneve dhe sjelljes.

Si shkaktarë kryesorë i tyre është depresioni , dhe simptomat që shfaqen dallojnë nga një person në tjetrin, kjo nga fakti se në çfarë rrethanash vjen çrregullimi mendor , sa personi është i gatshëm emocionalisht tu bëjë ballë problemeve, dhe me çfarë intenziteti ndikojnë ato rrethana te njeriu, dhe në ç’kohë individi fillon të merr masat për të luftuar problemin e caktuar.

Pra ,shëndeti mental është gjëja më e rëndësishme dhe më me vlerë e çdo individi. Ajo përfshin aftësinë për të jetuar jetë të plotë si dhe përballjen dhe menaxhimin me sfida të ndryshme që ballafaqohemi gjatë tërë jetës. Përparimi dhe ruajtja e shëndetit mental arrihet në familje, shkollë si dhe rrethin në të cilin jetojmë . Qëllimi i zbulimit të hershëm , diagnosifikimit ,trajnitimit si dhe rehabilitimit konsiderohet si preventivë kundër veprave të ndryshme në jetë, të cilat mund të ndikojnë negativisht në rrethin si dhe mbi personin i cili kryen veprë. Prevencioni i veprës mund të arrihet nëpërmjet njohjes së personalitetit të individit, shkakut, veprimit, terapisë , dmth të gjitha nën vëzhgimin

¹⁵ C’duhet të dish për çrregullimet mendore, Dëshmitarët e Jehovait , 2014 - Artikull

e kornizës shëndetësore, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit mendor.

Në çrregullimet mendore ndikon zanafilla e të gjithë atyre fenomeneve biologjike , psikologjike dhe sociale te cilat më shumë ose më pak ndikojnë në aktivitetin ose reaktivitetin e individit.¹⁶ Çrregullimet mendore janë karakterizuar nga ndryshime në të menduarit, humor ose sjellje (ose ndonjë kombinim të këtyre elementeve), të cilat janë të lidhura me siklet dhe funksionimin të dëmtuar, zakonisht gjatë një periudhë të zgjatur. Simptomat e çrregullimeve mendore ndryshojnë nga të lehta në shumë serioze, të cilat varen nga lloji i çrregullimit mendor, vetë personi, familja e saj dhe mjedisi socio-ekonomik.

Gjatë jetës, çdo person përjeton një ndjenjë izolimi, vetmie ose siklet emocional. Këto janë, zakonisht, reagime normale, afatshkurtra ndaj situatave të rënda, në vend të simptomave të çrregullimeve mendore. Njerëzit mësojnë të merren me ndjenjat e vështira, siç bëjnë me situata të vështira. Megjithatë, në disa raste, kohëzgjatja dhe ashpërsia e ndjenjave të dhimbshme ose modele të ndryshuara mendimi mund të ndikojnë seriozisht në jetën e përditshme të personit. Mekanizmat e mbrojtjes së përbashkët nuk janë më të mjaftueshme dhe këta njerëz mund të bëhen të domosdoshëm për të ndihmuar në rivendosjen e ekuilibrit dhe rikthimin në funksionimin e plotë. Për shembull, një person në të njëjtën kohë mund të jetë në depresion dhe të ketë disa nga çrregullimet e ankthit.¹⁷ Shëndeti mendor është i rëndësishëm për jetën e përditshme, po aq sa edhe për shëndetin fizik. Për më tepër, ato ndërthuren. Korrelacioni midis kryerjes së krimit dhe çrregullimeve mendore qëndron në atë se personat që kryejnë vrasje dhe forma të tjera të krimit të dhunshëm kanë gjasa të shfaqin një çrregullim personaliteti të një lloji apo një tjetër. Në thelb çdo çrregullim i personalitetit mund të lidhet me krimin e dhunshëm, me përjashtim të mundshëm ose shmangës. Format më të zakonshme të krimit të dhunshëm janë vrasje (duke përfshirë edhe vrasjen në tentativë), të tmerrshëme, sulmi, përdhunimi, të gjitha këto përfshijnë ose lëndime serioze ose vdekje, vuajtje ekstreme fizike, apo të dyja. Do të ishte e lidhur ngushtë me këto forma të krimit: rrëmbimi me shkaktimin e vuajtjeve fizike, pasi së paku do pasonjen vuajtje të rënda psikologjike. Rendizimi i një viktime të paaftë përbën edhe një mjet tjetër për të shkaktuar vuajtje ekstreme,, të plagosjes fizike nga thika ose instrument të hapur etj. Shumica e personave që bëjnë dhunë dhe krime, qofshin të zakonshme ose në rrethana unike, shfaqin një çrregullim personaliteti. Për më tepër, personaliteti i disa shkelësve të dhunshëm mund të kuptohet më mirë brenda kontekstit të tipeve të personalitetit. Sa për lidhjen mes personalitetit, konfigurimit dhe llojit të krimit, kjo mund të jetë mjaft e ngushtë, si në rastin

¹⁶ Kreshnik Myftari, Disertacion: Papërgjegjshmëria përshkak të gjendjes mendore. Kriteri Juridik në të Drejtën Penale, fq. 10, Tiranë 2014

¹⁷ Kreshnik Myftari, Disertacion: Papërgjegjshmëria përshkak të gjendjes mendore. Kriteri Juridik në të Drejtën Penale, fq. 13, Tiranë, 2014

e vrasjeve masive ose seksuale dhe vrasjeve seriale . Por vrasje të vetme, veçanërisht brenda familjes, mund të kryhen nga persona të llojit të çdo personaliteti . Një mënyrë për të kuptuar çrregullimet e personalitetit në përgjithësi është t'i shohësh ato si dispozita të zakonshme në drejtim të botës ndërpersonale - atë kufi ,opsionet e dikujt në lidhje me situatat stresuese, dhe prandaj përshtatshmëria është më e ulët. Çrregullimi i personalitetit kufitar lidhet me një shumëllojshmëri të gjerë të simptomave psikiatrike dhe sjelljeve aberrante. Në këtë temë ne diskutojmë lidhje të rrallë të ekzaminuar midis çrregullimit të personalitetit kufitar dhe kriminalitetit. Sipas rishikimit tonë të literaturës, në krahasim me normat e çrregullimit të personalitetit kufitar të hasura në popullatën e përgjithshme, çrregullimi i personalitetit kufitar është i mbi-përfaqësuar në shumicën e studimeve të të burgosurve. Mund të nxjerrim disa përfundime të përgjithshme nga të dhënat e mësipërme. Së pari, në studimet që njëkohësisht krahasojnë burrat dhe gratë, normat në mesin e meshkujve duket të jenë vazhdimisht më të larta se tek gratë.

Sipas të gjeturave të shumicës së studimeve në këtë fushë, krahasuar me normat e pritshme në komunitet, çrregullimet mendore janë të mbi-përfaqësuar në popullatat e burgjeve. Ky zbulim mund të jetë veçanërisht i dukshëm midis të burgosurve meshkuj. Normat ndryshojnë, varësisht nga metodologjia, por në përgjithësi duket se janë në rangun prej 2 deri 5 përqind. Faktorët që mund të shoqërohen me praninë e çrregullimeve mendore në mesin e kriminelëve përfshijnë të qenit meshkuj, me një histori të keqtrajtimit në fëmijëri, kryerjen e një krimi impulsiv dhe të dhunshëm (p.sh. vrasje), që kanë tipare antishoqërore të personalitetit dhe bëjnë dhunë në familje. Duke pasur parasysh këtë shoqata e mjekëve të shëndetit mendor dhe të kujdesit parësor duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësitë e historive të tilla në pacientët e tyre me çrregullime mentale.

Duke hulumtuar të gjitha kategoritë e sëmundjeve psiqike, në bazë të klasifikimeve të veprave penale rezulton se një numër i madh i veprave penale janë kryer nga persona me çrregullime mentale dhe çrregullime të personalitetit, rezultat i të cilave janë manifestuar sjelljet antisociale. Nga studimet empirike të shumë autorëve , si përfundim rezulton se veprat më të lehta penale kryhen nga popullata e përgjithshme, ku përfshihen vjedhjet dhe veprat jo të dhunshme, kurse personat me çrregullime të personalitetit kryejnë vepra penale si : dhunimi, grabitjet ku konsiderohen , si shkalla më e lartë e sjelljeve kriminale.

Duke analizuar çrregullimet psiqike dhe kuptimin e tyre forenzik psikiatrik vërejmë gërshetim

midis veprës penale dhe çrregullimit psikiatrik , ku vepra penale është pasojë e kryerjes së aktit impulsiv dhe të dhunshëm të instikteve , ajo është pasojë e vartësisë (alkoolit dhe drogës) dhe smundjeve sociopatologjike, dmth ekziston lidhja shkakore (kauzale) e çrregullimit psiqik. Dukuria e kriminalitetit më së shpësthi manifestohet tek të sëmurët psiqik se sa tek popullata e përgjithshme. Gjatë studimeve për punimin e tezës në burgun e Demir Hisarit\Idrizovës, ku janë vendosur të vuajnë dënimin këto persona, disa prej tyre kanë treguar çrregullim ansioz-depresiv , kurse një numër ivogël me skizofreni dhe çrregullim personaliteti.

Kur jemi tek vepra penale dhe kuptimi i tyre forenziko-psikiatrik duhet të ceket se :

- Vepra Penale dhe çrregullimi psiqik koincidojnë – kjo rrjedh si pasojë e asaj që të sëmurët psiqik i janë lënë vetes, bredhin lirshem rrugëve , shoqërohen me kriminelë, mblidhen në kafene dhe shpesh herë janë të nxitur prej të tjerëve të bien pre e zenkave ose konflikteve të dhunshme .

- Vepra Penale është pasojë e çrregullimit psiqik—Shpesh e kemi hasur bindjen se të sëmurët skizofren kryejnë vepra të rënda penale .

Ndonëse kjo ndodh rrallë herë , përshtypja dhe bindja janë krijuar meqë ato janë agresiv , kataton dhe paranoik. Vepra Penale të cilën e kryejnë ato janë si rezultat i ndikimit të halucinacioneve , ideve të kota , të ndjekjes apo ndjenjave imperative.

Dmth. Dhuna apo vepra penale e kryer nga personat skizofren është katër fish më e madhe se sa te popullata normale.

- Veprën Penale e ka shkaktuar çrregullimi psiqik—Nëse ndodh për herë të parë të kryhet vepër penale nga një individ që më përpara nuk ka shfaqur simptoma të çrregullimit psiqik dhe është ndeshur me ligjin , nga situatë stresuese pas kryerjes së krimit tek ai paraqiten çrregullimi disiciative(amnesia), çrregullimi depersonalizues , adaptive dhe sindroma Pseudatement (Ganser).

Si kryes të veprave penale ashtu edhe viktimave më pastaj u shfaqet flash-back i asaj që ka ndodhur, ose e tëra u shfaqet në gjumë duke pasur ankthe dhe duke shfaqur dhimbje patologjike. Në disa raste , mund të ceket se vepra penale është rezultat i personalitetit të sëmurë, sepse shpesh ndodh që këto persona janë anti-social, dhunën e shfaqin që në moshë të vogël, mirëpo kjo mund të caktohet vetëm pas moshes 18 vjeçare. Mirëpo në këto raste është e domosdoshme

analiza klinike të vërtetohet nëse këto persona simulojnë.

- Vepra penale është pjesë e personalitetit të sëmurë—Diagnoza e çrregullimit të personalitetit përcaktohet pas moshës 18 vjeçare, ndonëse ato shfaqin tendenca dhe shenja të dhunshme që në fëmijëri.

Prevalenca e çrregullimeve antisociale tek meshkujt është 5% kurse tek femrat 3%.

Nga çrregullimet e tjera të personalitetit si ai gangrik dhe histerik , kryejnë vepra penale kryesisht seksuale .

Çrregullimi narcizoid i personalitetit shpesh është i lidhur për veprave penale të mashtrimit , kurse çrregullimi paranoid më së shpeshti përfshihet në posedimin e paligjshëm të armëve, eksplozivit si dhe veprave simuluese.¹⁸

- Vepra Penale është pasojë e kryerjes së aktit impulsiv dhe të dhunshëm të instikteve—në këtë grup perveç atyre me çrregullime mentale bëjnë pjesë edhe kleptomanët dhe piromanët.

Kur bëhet fjalë për përgjegjsinë penale të kryesve me aftësi të kufizuara të të menduarit apo me çrregullime mentale, me të cilat i kanë shkaktuar dëm individit apo shoqërisë u japin një status të posaçëm personave me smundje psiqike.

Gjendja e posaçme në të cilën gjenden këto kryes e arsyeton përcaktimin e masave të posaçme ligjore si masa e detyrueshme e shërimit psikiatrik. Gjithashtu mënyra e kushtëzimit të ekzekutimit të këtyre masave nvalet nga mënyra e kryerjes së veprës së veprave penale dhe shkallës së smundjes mentale që e ka.

E drejta penale në drejtim të humanizmit të dënimit dhe përcaktimit të tij, ka nxjerrë në pah sanksionet penale të cilat u shqiptohen kësaj kategorie të personave të papërgjegjshëm dhe personave me përgjegjisi të zvogëluar esenciale. Mirëpo për shkak të gjendjes së sëmurë psikike në të cilën gjenden këto persona gjendja e tyre paraqitet si shkaktar kryesorë i kryerjes së veprës penale.

Në pajtim me zhvillimet demokratike dhe Akteve Ndërkombëtare e cila ka evoluar përcaktimi i masave të detyrueshëm psikiatrik u dedikohet kryesve të papërgjegjshëm e cila është e rregulluar mbi parimin e ligjshmërisë , humanizmit dhe represionit, orientohet në prevencionin duhet të zbatohet në përpikmëri me legjislacionin pozitiv në parandalimin krimeve dhe ndëshkimin e kryesve që ti kthejë ato në persona të risocializuar të edukuar dhe të aftë për të jetuar duke

¹⁸ Sllobodan Lloga, Psikopatologjia Gjyqësore, Prishtinë, 2007, fq 12

respektuar korrnizat e caktuara ligjore.

Mirëpo kjo do të ishte e pamundur ngase aftësia e personave plotësisht të papërgjegjshëm është e ulët , ngase ato nuk mund të mendojnë dhe gjykojnë sepse këto persona karakterizohen nga një gjendje e veçantë psiqike nga e cila nuk mund të kontrollojnë sjelljet e tyre.

Trajtimi i kësaj katedorie të individëve me kryesit e tjerë të veprave penale të cilët janë të përgjegjshëm penalisht do të ishte në kundërshtim me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Këto persona qoshin me pergjegjësi esenciale të zvogëluar apo të papërgjegjshëm gjenden në rrethana të cilat na kushtëzojnë që tu sigurohet trajnim i posaçëm gjat procedurës penale , përzgjedhjes së masave ndëshkuese si dhe ekzekutimit të tyre.

Rrethanat pasojnë si rrjedhojë e të metave të tyre psiqike në të cilën gjenden ato.

Dallimi nga kriteri mjeksor dhe atij juridik për vlersimin e gjendjes mendore në momentin e kryerjes së veprës penale qëndron në atë se kriteri mjeksor vleron gjendjen dhe turbulencën e individit në momentin e kryerjes së veprës penale.

Ky kriter parashikohej që në shkollën klasike të së drejtës penale.

Kriteri juridik, nënkupton disiplinimin me ligj të kriterit mjeksor për konstatim të përgjegjshmërisë esenciale ose të papërgjegjshmërisë.

Kriteri juridik përbëhet nga dy elemente, nga momenti intelektual që parashikohet në shprehjen "nuk ka qenë në gjendje të kuptojë se kryen vepër penale", pra mungesën e vetëdijes së personit, të kuptojë rëndësinë e veprës dhe pasojat e saj, dhe nga momenti volitiv, që pasqyrohet në shprehjen "nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij."¹⁹ Në psikiatrinë forenzike me rëndësi do të ishin edhe aspektet etiologjike duke vlerësuar se në çfarë shkalle dhe mënyre është kryer vepra penale.

Dallimi përbën papërgjegjshmërinë natyrore e cila nxjerrë në pah gjendjen mendore të individit që atë nuk e lejon të mendojë për veprën që ka kryer dhe pasojat që kanë ardhur si pasojë e veprimit ose sjelljes që ka patur me anë të së cilës nuk ka shprehur ndërgjegje. Kjo dmth quhet papërgjegjshmëri e lindur ose zhvillim i metë mendore.

Si do që të jetë këta dy elemente ngelen abstrakt pa kriterin mjekësor , pa u përcaktuar çrregullimi mental dhe prishja e ekuilibrit psikik të individit. Kodi Penal parashikon se për çdo vepër penale është e nevojshme ekspertiza psikiatrike për tu vërtetuar përgjegjshmëria esenciale apo papërgjegjshmëria. Për ekzistimin e çrregullimit mendor , gjykatat nuk duhet ti referohen

¹⁹ Shefqet Muçi "E drejta penale, pjesa e përgjithshme", 2007, fq. 133

vetëm një rasti të ndodhur , por është e nevojshme të përcaktoj të dhënat klinike, psikiatrike , dhe sjelljes që rrjedhin nga vetë veprimi i tyre.

Në këtë linjë duhet të bazohet jurisprudenca për vlerësimin e drejtë të papërgjegjshmërisë, jo duke ju referuar klasifikimeve shkencore me përmbajtje abstrakte, pasi sëmundjet mendore kanë ecuri të ndryshme në subjekte të ndryshme dhe ndikojnë në mënyra të ndryshme në aftësinë intelektuale dhe volitive. Klasifikimi tipik i sëmundjeve mendore i përgjigjet më tepër nevojave studimore dhe jo atyre juridike. Gjykatat në vlerësimin korrekt nëse ka ose jo humbje të aftësisë, papërgjegjshmëri, nuk ka pse të jenë të kushtëzuara nga skemat psikiatrike.²⁰ Koncepti i papërgjegjshmërisë, për mendimin tonë, është tërësisht në funksion të së drejtës, edhe pse çrregullimi vlerësohet nga mjekët psikiatër. Papërgjegjshmëria, si kriter i përjashtimit nga përgjegjësia penale, nuk parashikohet në shkencat mjekësore për aq kohë sa nuk jemi përballë një vepre penale. Ndaj një të sëmurë mendor që në një moment të caktuar i mungon zotësia juridike për të vepruar, nuk përdoret termi “i papërgjegjshëm”, por konsiderohet thjeshtë i sëmurë mendor. Termi “i papërgjegjshëm”, ndryshe nga termi “i sëmurë mendor”, lidhet me veprimin konkret të kryer nga subjekti. Ai mund të jetë i sëmurë mendor, por akoma nuk ka kryer një veprim të kundërligjshëm dhe nuk ka arsye që të konsiderohet i papërgjegjshëm. Të dy kriteret duhet të jenë në funksion të plotë dhe të vazhdueshëm, sepse ndërsa kriteri mjekësor përcakton praninë e sëmundjes psikike, ai juridik shpreh shkallën e thellësisë së çrregullimeve të veprimtarisë psikike.²¹ Konstatimin se a është përgjegjës për veprën e kryer të një personi e bën mjeku psikiatër forens. Vlersimi i mëtejshëm që bëhet është tërësisht në kompetencë të gjykatës e cila mund të bëjë pyetje në lidhje me aktin e ekspertimit , të rishikojë rastin dhe më e rëndësishmja gjyqtari është ai që do të japë vendimin përfundimtar.

Gjykata shikon aktin e ekspertimit me të gjitha provat e evidentuara dhe të administruara gjatë procesit penal dhe ka të drejtë që për çdo dyshim të arsyeshëm të kërkojë ekspertim të ri ose ta pranojë ekspertimin nëse nuk ka dyshim për çështjen apo rastin konkret, duke i shikuar edhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Pra është e mundur, që sëmundjet të klasifikoheshin si sëmundje psikike në aspektin mjekësorë , të mos kenë rëndësi në aspektin juridik për të përcaktuar papërgjegjshmërinë ose përgjegjësinë

²⁰ : Emilio Dolcini, Giorgio Marinuci “Codice Penale commentato, parte generale”, 1999, fq. 822.

²¹ Kreshnik Myftari, Disertacion: Papërgjegjshmëria përshkak të gjendjes mendore. Kriteri Juridik në Drejtën Penale, fq. 43, Tiranë, 2014

esenciale tek personat e sëmure psiqikisht ngase ato nuk kanë mundur të kuptojnë veprimin dhe pasojën e shkaktuar.

Në thelb nocioni i papërgjegjshmërisë, për të marrë rëndësi në profilin juridik, duhet patjetër të mbështetet në një çrregullim funksional të vazhdueshëm mendor, në atë masë sa të dëmtojë ndjeshëm vetëkontrollin e një subjekti dhe të ndikojë dukshëm në autonomi funksionale të autorit të veprës.²²

Edhe pse kemi të bëjmë me dy kritere të rëndësishme si atë mjeksorë ashtu edhe atë juridik, pa marrë parasysh se çfarë lloji i veprës penale është kryer, dhe njohurisë psikiatrike që nevojitet prioritet i jepet gjithmonë kriterit juridik.

Në kuptimin e ligjit procedural dallimi i papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore përbën interes dhe rëndësi të veçantë gjatë procesit penal. Çrregullimi mendor që sjell papërgjegjshmërinë e personit nuk duhet të kuptohet vetëm ai çrregullim i cili shfaqet në momentin e kryerjes së veprës penale. Duke i përmbledhur, tre janë rrethanat kur i pandehuri mund të konstatohet i papërgjegjshëm, të cilat përbëjnë interes të veçantë në aspektin procedural:

1) papërgjegjshmëria e konstatuar në momentin e kryerjes së veprës penale, rrethanë e cila e bën personin tërësisht të papërgjegjshëm penalisht, sjell pushimin e ndjekjes penale ose të gjykimit dhe automatikisht vendosjen e masës mjekësore më të përshtatshme, të propozuar nga ekspertët dhe të miratuar nga ana e gjykatës.

2) papërgjegjshmëria e konstatuar gjatë procesit penal, e cila edhe pse nuk e bën të papërgjegjshëm penalisht personin, sepse nuk është shfaqur në momentin e kryerjes së veprës penale, e bën atë të papërgjegjshëm për t'iu nënshtruar procesit gjyqësor duke mos kuptuar se ai është marrë i pandehur, se ndaj tij po zhvillohet një proces gjyqësor, se ai gëzon të drejta dhe garanci kushtetuese. Pra në kushtet e konstatimit të papërgjegjshmërisë gjatë procesit penal, subjekti edhe pse ka qenë i përgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës, gjatë zhvillimit të procesit i shfaqet një sëmundje mendore që ul tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe rrjedhimisht aftësinë e tij për të kuptuar.

3) papërgjegjshmëria e konstatuar gjatë vuajtjes së dënimit, e cila haset shumë rrallë në praktikë, por kompromenton gjithë filozofinë e ndëshkimit, vuajtjes së dënimit dhe riedukimit. Me fjalë të

²² Kreshnik Myftari, Disertacion: Papërgjegjshmëria përshkak të gjendjes mendore. Kriteri Juridik në të Drejtën Penale, fq. 44, Tiranë, 2014

tjera, personi të cilit i shfaqet çrregullimi mendor gjatë vuajtjes së dënimit, në vetvete e bën dënimin jo efikas, për arsye se subjekti humbet lidhjen me realitetin, ai nuk e kupton dhe nuk e mban mend përse ndodhet aty. Në këtë formë dënimi humbet rëndësinë e tij ndëshkuese, pasi subjekti nuk arrin të perceptojë se po ndëshkohet për një vepër penale, madje nuk e kupton se çfarë është një vepër penale, por edhe rëndësinë rehabilituese, pra riintegrimin në shoqëri të personave që janë duke vuajtur dënimin, për arsye se, në institucionet e vuajtjes së dënimit, ndaj këtyre subjekteve nuk nevojiten orët e riedukimit, por nevojiten orët e kurimit, në kuptimin mjekësor të fjalës. Momenti në të cilin shfaqet çrregullimi psikik që sjell papërgjegjshmërinë e personit përcakton ecurinë e procesit, si dhe rezultatin përfundimtar të zgjidhjes së çështjes.²³ Sipas Kodit Penal ,person i paaftë mendërisht konsiderohet Personi i cili në kohën e vuajtjes së smundjes psiqike ka kryer vepër penale. Dmth ka lënguar nga ndonjë smundje psiqike të përkohshme ose të përhershme apo ka pasur ngecje në zhvillimin mendor dhe nuk ka mundur të kuptojë rëndësinë e veprës së kryer dhe të kontrollojë si dhe pasojës së shkaktuar. Siç shihet nga Kodi Penal këto persona që në kohën kur kanë qenë mentalisht të sëmure kanë kryer krim janë të papërgjegjshëm , ose me përgjegjisi esenciale.

Siç shihet sëmundjet mentale qofshin të përhershme ose të përkohshme janë smundje të sistemit nervor qëndror të intenzitetit të tillë që e bëjnë individin të papërgjegjshëm ose me përgjegjisi esenciale , tek i cili manifestohen disfunsione dhe çrregullime në jetën shpirtërore, siç janë çrregullimet në lëmin e instiktit të ndjesisë dhe afektit, në disponimin dhe temperamentin, në funksionet intelektuale të jetës si vrojtimi, mbajtja mend, njohja e personave, të menduarit etj.²⁴ Smundjet mendore mund të jenë të përhershme dhe të përkohshme.

Sëmundje mendore të përhershme mentale konsiderohen ato smundje të cilat përpos mjekimit ato nuk shërohen por me anë të medikamenteve mund të mbahen nën kontroll, aty takojnë: epilepsia, depresioni, skizofrenia etj. Ndërsa sëmundje mentale të përkohshme konsiderohen ato sëmundje të cilat paraqiten në çfarëdo kohe dhe moshe dhe janë të përkohshme , të cilat mund të shërohen për një periudhë apo afat të caktuar mjeksor.

Si rrethanë e dytë mund të cilët e bëjnë personin të papërgjegjshëm janë sëmundjet e përkohshme psiqike, ku kemi çrregullime të funksioneve psiqike, të vetëdijes , si pasojë e ndikimeve të

²³ Kreshnik Myftari, Disertacion: Papërgjegjshmëria përshkak të gjendjes mendore. Kriteri Juridik në të Drejtën Penale, fq. 46, Tiranë, 2014

²⁴ I. Salihu, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2008, fq. 280.

faktorëve të brendshëm ose të jashtëm dhe janë të paaftë për të kontrolluar ndjenjat dhe emocionet përfshirë edhe veprimet.

Rrethanë tjetër mund të ceket edhe ngecja mendore ose dementia. Kjo nënkupton moszhvillim të aparatit psiqik si pasojë personi është i paaftë të gjykojë dhe të mendojë.

Ngecja në zhvillimin mendor mund të jetë si pasojë e zhvillimit abnormal të fëmijërisë apo si shkak i izolimit të fëmijës nga rrethi shoqërorë.

Pra personat me çrregullime mentale trajtohen si delikuentë të veçantë, siç janë : psikopatët, neurotikët, psiko-neurotikët, personat emocionalisht jo stabil, të cilët mund të kryejnë vepra të ndryshme penale. Si çrregullime mentale që kanë lidhje me kriminalitetin mund të cekën: neurozat, psikopatitë dhe psikozat.

3.1.1. Neurozat

Kur flasim për neuroza e dimë që jeta bashkëkohore karakterizohet me dinamikë të zmadhuar në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore , përparimin njerëzorë, rritjen e komunikimit, urbanizimin masiv dhe periudhën e ashtuquajtur civilizim teknik.

Sot njeriu është i detyruar që për një kohë të shkurtër tu përshtatet ndryshimeve të mëdha jetësore në shoqërinë ku ai jeton. Vetë këto ndryshime bëjnë që njeriu permanent të pësojë edhe transformim personal. Kjo shpesh shoqërohet edhe me ankth , depression, ndeshje të emotiveve dhe emocioneve.

Neuroza është gjendje ku ekzistojnë ndryshime psikike të personalitetit, tek e cila paraqiten laramani të vuajtjeve psikike të karakterit subjektiv çka sjell deri te problemet e funksionimit dhe adaptimit personal , profesional dhe social.

Neurozat shpeshëherë tek njeriu zhvillohen pavetëdije. Ato janë mjaft të përhapura dhe shpeshëherë janë të nxitur nga faktorë emocional apo social-ekonomik.

Tek neurozat shfaqen ndryshime biokimike në të cilat mjekët neurologë kanë gjetur si shkaktarë faktorët emocional, kryesisht tipat e ndjeshëm.²⁵

Siç e thamë edhe më sipër, këto lloj sëmundjesh kanë pësuar rritje, dhe mund të themi se 30-40 për qind e popullatës në vendin tonë janë me këto shqetësime. Në vendet e tjera këto shifra janë

²⁵ Neurozat ndikojnë tipat e ndjeshëm, Gazeta Shekulli, 2016

më të ulëta, dhe variojnë nga 10-20 për qind. Studime të mirëfillta nuk ka pasur dhe nuk ka, por nga përvoja jonë e përditshme, duke u bazuar në atë çka shohim e them pa frikë, se shifrat mund t'i afrohen edhe 50 përqindëshit.²⁶

Termi I neurozës përshkruan gjendje apo smundje në të cilën çrregullohet ekuilibri i shëndetit mental.

Neuroza përfshin shumë probleme mentale të cilat variojnë nga ankthi , në fobi të thjeshta e deri në çrregullim të rënda me kohëzjatje opseshivo kompulsiv.

Si do që të jetë gjendja neurotike jep simptome siç janë : ankthi, depresioni dhe stresi.

Si simptom dominant tek smundjet neurotike janë:

Çrregullimet Anksiozo –depressive

Çrregullimet fobike

Çrregullimet opseshivo-kompulsive si dhe

Çrregullimet desociative

Neurozat siç e përmendëm edhe më lartë , janë smundje mjaft prezente dhe çrregullime të lehta shpirtërore.

Konflikti shpirtërorë I personit neurotik vjen atëherë kur ai nuk mund ti plotësojë apo kënaqë nevojat e vetëdijëshme apo të pa vetëdijëshme.

Mos përmbushja e kënaqësisë së këtyre personave çon deri tek konfliktet.

Personalitetin nuk e kanë të tjetërsuar , raportet dhe kontaktet i kanë normale.

Ato shfaqin shenja shqetësimi dhe padisponimi.

Ajo mund të shkaktohet si shkak nga frika e tërmeteve, frika nga lufta, fatkeqësive të ndryshme etj. dhe këto persona për veprat penale që i kryejnë i nënshtrohen përgjegjësisë penale.

Kuptimi i mekanizmave për llojet e caktuara kriminale formon një kompleks dhe konfuzion në psikopatologjinë e sjelljes njerëzore.

Mjekët tregojnë hap pas hapi lidhjen midis kriminit dhe smundjeve psikike që ndikojnë në kryerjen e tij.

Ekziston interes gjyqësorë të gjendjeve neurotike. Me të kyçura tek sistemi gjyqësorë si smundje subjektivo-neurotike na paraqitet amnesia neurotike e veçanërisht nëse personi hysteriko

²⁶ Po aty

neurotik ka qenë e perdhunuar apo nëse ka kyçur marrëveshje me palë tjetër e më pastaj është pënduar. Në këto raste duhet kyçur hulumtimi nga personat kompetent.

Neurozat dallohen nga psikozat.

Personat neurotik e injorojnë realitetin, ato kanë konflikt mes dëshirave personale dhe situatës së jashtme, gjegjësisht situatës në të cilën gjenden.

V. Micev neurozat do i përkufizonte si : “Neuroza është gjendje në të cilat ekzistojnë çrregullime psiqike tek personaliteti tek I cili paraqiten laramani të vuajtjeve psiqike të faktorit psiqik i cili ndikon në funksionimin dhe adaptimin e jetës profesionale, intime dhe planit social”.

Paraqitja e neurozave

Ekzistojnë shume tëori për paraqitjen e neurozave . Ato janë:

1) Teoria biologjike – Tentohet që të sqarohet se neuroza është faktor trashëgues , mirëpo ekziston vetëm shembull i “keq” në familjen e cila përmban më shumë persona neurotik.

2) Teoria psikoanalitike – Kjo është teoria e personalitetit. Këtu kërkohet që të sqarohet personaliteti i njeriut që në lindje e deri në kryerjen e krimit, dhe të sqarohet e vetëdijshmja dhe e pavetëdijshmja në lidhje me kryerjen e krimit.

Duhet të ceket se duhet të studiohen konfliktet, çrregullimet e fëmijërisë së hershme etj. të personalitetit të individit.

3) Teoria Biohevioreale- nënkupton atë se me të mësuarit gabim dhe sjelljes së keqe të njeriut sjell deri në arsyet kryesore të neurozës.

Klasifikimi i neurozave

Kur jemi tek klasifikimi i neurozave , edhe pse janë të shumta ,ne do ti cekim vetëm ato të cilat ndikojnë në shfaqjen e kriminalitetit, gjegjësisht në kryerjen e krimit.

1) NEUROZA ANKSIOZE –Këtu dominon anksioziteti, i cili shfaqet në formë të frikës se do të ndodhë diçka joreale që personave që vuajnë nga kjo gjendje u krijohet një fotografi reale e atij realiteti që mund të mos ndodhë.

Tek këto persona shfaqet frika, ankthi, pagjumsia etj.

Krimet që mund ti kryejnë këto persona janë në nevojë të vetëmbrojtjes, apo kur u cënohet morali etj, ato janë të gatshëm të kryejnë krime.

2) NEUROZA DEPRESIVE – Tek këto lloj neurozash dominon afekti depresiv. Këto persona ndjehen pa vullnet, pa dëshirë, kanë reaksione eksplozive dhe shpesh bien në zënka. Tek këto persona shpesh shfaqen edhe mendime suicide.

3) HISTERIA – shfaqet me sindroma të ndryshme psikike. Si të gjitha smundjet tjera psikike edhe histeria shoqëruet e ka depresionin. Këto persona sillen në mënyrë të papërgjegjshme, dhe prandaj edhe quhet la belle indiferece ose ndryshe “ indiferencim i këndshëm”.

Duhet të ceket se këto persona shpesh japin deklarata të rrejshme nëpër gjykata, u shkruajnë letra anonime personave të tjerë, të akuzojnë se janë të përdhunuara, etj Këtu veçmas ceket gjinia femërore.

Edhe pse këto smundje janë shumë prezente , rëndësia e tyre psikiatriko-gjyqsore është shumë e vogël.

Në praktikë personat neurotik mund të shfaqen si kryes të mëdhenj të krimeve më të rënda.

Në literaturë ekziston termin “ criminal neurotik” në të cilën individi i cili është në gjendje neurotike të gjithë atë barrë që e mbart në vete e drejton nga të tjerët, si p.sh vjedhjet e kryera. Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë ceket se neurozat janë gjendje të përkohshme , ashtu që personat neurotik janë të përgjegjshëm për kryerjen e krimin apo veprës penale, edhe pse kanë qenë në gjendje afekti, ato nuk llogariten si psikozat tek të cilët personat psikotik nuk janë apo pjesërisht janë të përgjegjshëm.

Neurotikët e kuptojnë se në momentin e kryerjes së veprës penale ato kanë kryer krim, por në mendjen e tyre , veprimi i cili e kanë kryer është në rregull.

Edhe pse gjendja neurotike nuk është e shëndoshë , kërkohet ekspertizë e mëtejshme e psihiatërve dhe neurolëgëve për konstatimin e tyre për të cilën duhet të përcaktohet gjendja afektive.

Mirëpo eksperti psikiatrik apo neuropsikiatrik nuk mund të konstatojë a ka qenë i përgjegjshëm ose jo personi neurotik në momentin e kryerjes së veprës penale , por pas analizës duke i mbikqyrur analizat, gjendjen momentale kur dhe si e ka kryer krimin , mund ti sugjerojë gjykatësit që gjendja në të cilën ka qenë personi neurotik të merret parasysh.

Nga të gjitha smundjet neurotike, amnesia hysterike paraqet problemin më të madh në kryerjen e

krimeve.

Pasqyrim I dy rasteve të amnezisë hysterike dhe një rast tjetër neurotik:

M. 36 vjeçar nga qyteti i Kërçovës, për një muaj ka kryer 5 vjedhje. Të gjitha vjedhjet janë kryer në mënyrë të njëjtë, prandaj organeve kompetente nuk u ka qenë rëndë që të zbulojnë se vjedhja është kryer nga personi i njëjtë.

Personi M. ka vjedhur mallëra nga më të ndryshmet, megjithatë e përbashkëta e të gjitha këtyre ka qenë se të gjitha këto shitore kanë qenë të mbyllura me dry, me anë të së cilës personi M. dryrin e ka thyer me shufër hekuri.

Në jedhjen e fundit personi M. ka rënë për toke dhe ka lënduar këmbën dhe shumë shpëjtë ka qenë i kapur nga organet kompetente.

Mirëpo gjatë hetimit është zbuluar se personi M. muaj më parë ka rënë nga 4 metra lartësi dhe ka pësuar lëndime në tru, pasojë nga e cila ai nuk është kujtuar për vjedhjet e kryera, gjë të cilën u aka deklaruar edhe organeve kompetente.

Gjatë hulumtimit të rastit nga psikiatri dhe eksperti i lëndës, është kërkuar që të vërtetojnë a ka qenë personi M. I vetëdijshëm për krimin e kryer gjatë periudhës Maj-Qershorë, 2010.

Mirëpo testet psikologjike treguan rezultate pozitive.

Gjë që është interesante është se personi M. nuk është kujtuar vetëm në situatat e pakëndëshme apo të këqija, përfshirë këtu edhe vjedhjet e shitoreve.

Është rëndë të besohet se 5 muajsh pas rënies nga lartësia 6 metrash që kanë kaluar para se të ndodhin vjedhjet, personi M. most ë kujtohet.

Personi M. është dërguar në spitalin psikiatrik në Shkup, andaj mund të ceket se personi M. ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme dmth (TEMPORE CRIMINALIS).

Dita kritike ka qenë kur personi A. nga një fshat i Kërçovës, në Nëntor 2013, punëtorë i thjeshtë në një firmë ka qenë në pushim mjekësorë, kurse gruaja e tij R. gjatë gjithë kohës e ka lodhur duke u grindur se pse ai nuk shkon në punë ose në kontrollë tek mjeku.

Gjatë kohës kur ai ka pushuar, gruaja e tij R. e ka zgjuar nga gjumi personin A. që ai të kujdeset

për vajzën e tyre 5 vjeçare.

Në atë moment personi A. është zgjuar dhe ka filluar zënkë me bashkëshorten e tij R. duke i rënë shuplaka dhe shkelma dhe më pastaj duke e sulmuar me sopatë deri në vdekje.

Edhe pse personi A. qëndroi për një kohë në burg, ai deklaroi se nuk kujtoheshte se çka ka ndodhur.

Gjatë bashkëbisedimit me ekspertët psikiatrik dhe neuropsikiatrik personi A. mbanë mend gjithëçka që nga datëlindja e tij, kur është martuar, emrin e fëmijës e deri në momentin kur ka ndodhur rasti.

Këtu bëhet fjalë për anamnezë funksionale (moskujtesë).

Ky përshkruhet si rast kur personi ka frikë nga realiteti apo ndodhia dhe nuk do që ta pranojë faktin ndodhur e të pakëndshëm ose ta fshijë këtë kujtesë.

Mirëpo gjendja e atëhershme psiqike nuk mund të kishte ndikim në vendimin gjyqsorë, pasi që krimi është kryer në momentin kur personi A. ka qenë shëndoshë.

Personi A. si opsion tjetër ka pasur edhe qëndrimin në psikiatri, në vend të qëndrimit në burg, përderi sa të shërohet dhe më pastaj të vazhdojë dënimin në burg.

Të njëjtin tretman e kanë edhe personat histerik, të cilët duan të ikin nga realiteti, apo të harrojnë rastin e pakëndshëm që u ka ndodhur dhe atë e shëndërrojnë në sëmundje. Megjithatë kjo simptomatologji nuk vë në pyetje vetëdijen.

Tek këto persona d.t.th që momentin e pakëndshëm e shtypin në nënvetëdije pasi që nuk u konvenon.

Aktvendimi kundër N. nga qyteti i Kërçovës , në Mars të vitit 2009 , përmbante atë se ai në mënyrë çnjerëzore ka vepruar me të ndjerën A. , me të cilën ka qenë në bashkësi martesore prej 15 vitesh dhe me të cilën ka pasur dy fëmijë , 10 dhe 13 vjeçarë. Ai të ndjerën shpesh e ka sulmuar dhe maltretuar fizikisht.

Në ditën e krimit, ai është kthyer nga puna , në shtëpinë e tyre të përbashkët , ka filluar zënka midis tyre, dhe ai ka filluar që ta godasë me shuplaka dhe shkelma të ndjerën në tërë trupin, dhe me zorrë për vaditje prej 5 metrash I ka shkaktuar lëndime të rënda trupore: thyerje të rebrave VI-XI.

Përshkak të kësaj e lënduara po atë natë ka marrë acid klorhidrik 3dl. dhe e ka pirë, me qëllim që të kryejë vetëvrasje. Në të njejtën natë rrugës për në Shkup ajo vdes.

Gjyqi pyet:

1. Në çfarë gjendjeje psiqike ka qenë i akuzuati?
2. Çfarë personi ka qenë i akuzuari dhe a ka qenë nën ndikimin e alkoholit?

Anamneza dhe heteroanamneza e N. gjatë kontrollimeve nga ana e ekspertëve psikiatrik dhe neuropsikiatrik, rezulton se ai ka qenë person neurotk, me simptomatologji emotive labile.

Storia e N. tregon se ai gjithëmon ka gjetur shkaqe për zënka me familjarët dhe kolegët e tij të punës dhe shpesh herë ka qenë agresiv dhe gjithë kjo ka rezultuar në veprim, gjegjësisht aksion. Kjo d.t.th se edhe punë më të vogla apo zënka më të thjeshta ai ka rënë në konflikte, të zihet apo të godasë dikë.

Fakt për këtë është se ai gjithmonë pas ka kërkuar që të pajtohet.

i akuzuari për smundjen neurotike që e ka, është arsyetuar duke akuzuar babain e tij të cilin kur ka qenë fëmijë ka ushtruar dhunë mbi të dhe shpesh herë e ka dënuar për gabime më të vogla duke e mbyllur në dhomë me ditë të tëra.

Përshkak të kësaj ai ka filluar edhe konsumimin e alkoholit dhe bixhozin, gjë që nuk e pranon, mirëpo kuptohet në bazë të sjelljes së tij.

Megjithatë duhet të çeket se ai ka qenë punëtorë i mirë, njeri familjarë në fillim, d.m.th deri kur kanë filluar neurozat dhe me anë të medikamentëve dhe tëerapisë është pritur përmirësimi i gjendjes.

Sa i përket konsumimit të alkoolit dhe bixhozit, ato janë shenjat e sëmundjes neurotike të personit N. dmth bëhet fjalë për konsumim simptomatik të alkoolit.

Në ditën e kryerjes së dhunës ndaj bashkëshortes së tij duhet të ceket se personi N. nuk ka qenë nën ndikimin e alkoolit, gjë që nuk ndikon në atë se e ka kryer krimin me paramendim apo jo.

3.1.2. Psikopatitë

Shpesh herë në jetën e përditshme kur e dëgjojmë fjalën psikopat , na asocion me njeri të çmendur apo vrasës.

Në fakt, një person psikopat nuk është njeri i çmendur apo ndonjë vrasës. Ai person është njeri antisocialdhe e ka vështirë të ruajë marëdhëniet me të tjerët.

Psikopatia, paraqet devijim të personaliteti.

Personat psikopat nuk janë të ndjeshëm. Atyre asnjëherë nuk u zihen besë ndjenjat. Kjo është një nga karakteristikat kryesore të këtij çrregullimi.

Si karakteristika tjera kemi:

Papërgjegjshmëria – pretendohet vazhdimisht, duke mos përfillur rregullat dhe kufizimet sociale.

Vështirësia për të mbajtur mardhëniet me të tjerët – paradoksal është fakti se këto persona e kanë të lehtë të krijojnë mardhënie me të tjerë, por shumë të vështirë për ti ruajtur këto mardhënie.

Intoleranca prej zhgënjimeve – Këta persona nuk e durojnë dot faktin e të mos pasurit gjërat që i dëshirojnë këta, ndërsa pragu i agresivitetit është tepër i ulët në këtë drejtim: nevríkosen shumë shpejtë.

Tendenca për të fajësuar të tjerët- Personat psikopatë shpjegojnë vështirësitë e tyre në mënyrë shumë racionale me shoqërinë që i rrethon, duke i akuzuar të tjerët të jenë fajtorë, madje në mënyrë shumë bindëse.

Në këndvështrimin juridik, duhet cekur se psikopatia është shumë e ndërlidhur me veprimet kriminale. Zakonisht krimet të cilat i kryejnë psikopatët nuk janë të nxitura, por janë të planifikuara mirë nga ato. Motivi i tyre përfshin fuqinë, kontrollin dhe kënaqsinë sadiste. Edhe pse vrasjet e tyre makabre janë të ftohta , duhet cekur se ato kur përballen me prova kundër tyre ato pretendojnë se veprën penale e kanë kryer në gjendje zemërimi.

Shkelësit e ligjit që janë psikopatë janë në gjendje të sulmojnë, dhunojnë dhe vrasin, duke mos u penduar për shkeljen ligjore që e kanë bërë si dhe pasojat moralo juridike që pasojnë.

Përdorimi i dhunës është më ekstreme dhe kanë histori të krimeve të larmishme.

Psikopatia shpesh mund të diagnostifikohet apo interpretohet keq nga ana e ekspertëve profesionist, si pasojë e trillimit dhe mashtrimit të psikopatëve me qëllim që ti ikin përgjegjësisë penale që vijon.

Sipas të dhënave , psikopatët janë indiferent ndaj pyetjeve apo kur bëhet fjalë për krimet e kryera nga ana e tyre si dhe kur ceken viktimat.

Si rezultat i arrogancës së tyre kur bëhet fjalë për pendesën e tyre , gjë që ndikon në zbutjen e dënimit të tyre kur është fjala për përgjegjshmëri e tyre penale ato shumë lehtë mund të imitojnë emocione para gjykatës.

Psikopatët kanë super-ego të pazhvilluar , i cili rezulton në qenien psikopatike.

Të tre llojet e psikopatisë edhe pse dallohen nga njëra tjetra ato sit ë përbashkët kanë të njejtën mungesë të ndjeshmërisë emocionale dhe etike, e cila rezulton në sjellje të ndryshme

kriminale.Këto persona me disharmoni shpirtërore funksionet intelektuale kryhen pa pengesa të mëdha mirëpo ato nuk mund ti përshtaten ambientit social ku jetojnë.

Shkaqet e çrregullimeve psiqike të këtyre personave mund të jenë të trashëguara, të lindura dhe të fituara gjatë jetës.

Llojet e tipave psikopatë dhe karakteristikat e tyre

1. Psikopatë Epileptik- tek këto psikopatë kemi ego të theksuar,sepse veprimet dhe sjelljet e tyre theksohen me brutalitet të vrazhdë.

Këto persona kërkesat dhe dëshirat e tyre i realizojnë pamarrë parasyshtë pengesat. Prandaj këto persona kanë rrallëherë përgjegjshi të zvogëluar sepse veprat penale ose krimet i kryejnë nga frika ose në gjendje afekti.

2. Delikuentët Impulsiv- këto janë persona gjaknxehtë , dhe kanë problem me egon e tyre, dmth nuk besojnë në forcën e egos së vet. Krimet që i kryejnë këto persona janë si shkak i lirimit të forcave intrapsikike , që rezulton në lirimimin e ngarkesës që e mbartin

3. Psikopatët Cikloid- Këto persona janë më Ego dominante , shpesh e ndërrojnë disponimin dhe ndahen në grupe dhe dallohen si persona te fuqishëm dhe udhëheqës.

Tek këto persona dominon ambicje e tepëruar. Këto persona janë përgjegjës dhe krimet i kryejnë me vetëdije.

Psikopatët patologjik ndahen në: optimist patologjik dhe pesimistë patologjik.

Pesimistët patologjik mund të kryejnë krime të rënda si : vrasje , vetëvrasje ,lëndime të rënda trupore etj.

4. Psikopatët Histerik- Karakteristikë e tyre është se paraqiten shumë të mirë. Ato mund të jenë

rrenacakë histerik, intrigant histerik, janë të aftë në punë ,mirëpo veprimet e tyre janë egocentrike dhe vetjake. Krimet më të shpeshta që ato i kryejnë janë: mashtrimet , prezantimet e rrejshme etj.

5. Psikopatët Shizoid- janë frikacakë dhe depresiv dmth kanë personalitet të dobët.

Këto persona lehtë bijnë nën ndikimin e nxitjeve të të tjerëve, i përshkon ndjenja e nënshtimit.

Përshkak të frikës dhe shantazhit kryejnë krime të ndryshme.

Grup tjetër i psikopatëve shizoid llogariten “ekstravagantët” të cilët kryejnë krime nga urrejtja apo hakmarrja.

Siç e pamë personat me smundje të psikopatisë trajtohen në mënyrë të veçantë pa marrëparasysh krimin e kryer.

3.1.3. Psikozat dhe kriminaliteti

Psikozat janë sëmundjet më të rënda shpirtërore. Këto sëmundje mund të jenë të përkohshme dhe të përhershme.

Si të përkohshme mund të konsiderohen : dipsomania, mania periodika, melankolia periodika etj. Shkaqet e paraqitjes së psikozave mund të jenë : të trashëguara, të lindura dhe të paraqitura gjatë jetës.

Lidhur me paraqitjen e psikozave kemi ndarje të autorëve ku disa mendojnë se sëmundjet psiqike nuk ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit e disa të tjerë e paraqesin si faktorë kryesorë në shkaktimin e krimeve të ndryshme të rënda e makabre.

Psikozat dhe llojet e tyre:

Skizofrenia

Është psikozë tek e cila kemi ndarje ose disocim midis të menduarit dhe afektit të personit skizofrenik.

Simptomat e skizofrenisë përfshijnë gjithë funksionet psikologjike, për arsye se ajo është sëmundje e tërësishme e personalitetit.

Në sferën emocionale kemi mospërputhje midis disponimit dhe mimikave, mospërputhje midis

midis ngacmimit dhe afektit, ambivalencë afektive, humbet vetpërmbajtja, instikti I seksualitetit dhe shoqërorizimit.

Në sferën e të menduarit kemi çrregullime intensive (shkatërrime mendimesh, ide të çmendura).

Në sjellje kemi dobësim vullneti, sjellje të paparashikueshme impulsive, negativitet etj.

Në sferën perceptuese kemi paraqitje të halucinacioneve me akoazima e deri te paraqitja e zërave me karakter të ndryshueshëm dhe shumica e këtyre personave dëgjojnë zëra dhe kanë halucinacione.

Skizofrenia ndikon në mënyrën në të cilën personat mendojnë, ndjejnë dhe sillen.

Këto persona shumë rëndë e dallojnë realitetin përshkak të konfuzionit në të cilin gjenden, prandaj kanë problem të komunikojnë dhe të socializohen me persona të tjerë.

Arsyeja e vërtetë e burimit të kësaj sëmundje ende është e panjohur, mirëpo shkencëtarët mendojnë se rrjedhën e ka nga kombinimi gjenetik dhe disbalanci truror.

Sëmundja e skizofrenisë është kronike dhe është e përhapur në të gjitha kulturat dhe kohërat.

Dyshohet se rreth 3-6 nga 1000 persona vuajnë nga sëmundja e skizofrenisë, por varësisht nga vendi në vend numri ndryshon, dhe kemi statistika të ndryshme.

Tek skizofrenia dominante e kemi çrregullime të rënda mentale dhe sociale.

Kemi pesë lloje të shizofrenisë:

- **Shizofrenia paranoid**- personat të cilët vuajnë nga kjo sëmundje mendojnë se persona apo grup individësh i ndjekin apo flasin për to.

Mirëpo duhet cekur se ekziston dilemma nëse bëhet fjalë për një sëmundje apo grupë sëmundjesh dhe rrethanash të cilët rezultojnë në Skizofreni.

Etipopatogenezja e skizofrenisë, është ende e panjohur edhe pse në patogenezën e skizofrenisë ekzistojnë drejtime të ndryshme, kështu që mund të vijmë në përfundim se ato mund të jenë biologjike, psikike dhe sociale.

Sipas hipotezës gjenetike përveç faktorit gjenetik ndikojnë edhe rrethana të ndryshme të cilat përmbliidhen dhe krijojnë këtë sëmundje. Megjithatë është rëndë të caktohet përshkak të gjendjes specifike.

Në pikëpamjen ligjoro-juridike , kur bëhet fjalë për përgjegjësinë penale tek delikuentët të cilët vuajnë nga skizofrenia , dallojnë nga njëra tjetra prandaj edhe është shumë rëndë të caktohet

gjendja e vërtetë tempore criminalis.

Kjo bëhet edhe më e rëndë në qoftë se i sëmuri psiqik vetë e simulon sëmundjen psiqiko skizofrenike.

Rast qetër i rëndë paraqet edhe i sëmuri skizofrenik i cili ne momentin e kryerjes së krimit ka qenë i sëmure por më pastaj pas 2 javësh ose 1 muaji është shëruar. Prandaj në këtë rast me precizitet duhet të caktohet sakt sëmundja dhe përgjegjsia e të sëmurit skizofrenik si dhe rrethanën në të cilën e ka kryer krimin të cilat në mënyrë direkte ose indirektë ndikojnë në shqiptimin e dënimit.

Rast tjetër i rëndë në caktimin e përgjegjesisë penale është e ashtuquajtura stadium prodromal, i cili parasheh se sëmundja ende nuk është shfaqur me intenzitet të rrezikshëm por shfaq vetëm disa shenja skizofrenie të cilat me anë të terapisë adekuate mund të mbahet pacienti nën kontroll me qëllim që të mos kryej krime. Kjo dmth prevencion i parakohshëm.

Tek këto persona shpesh paraqitet fotografi klinike e agresivitetit , nervozizmit, shqetësimit etj. Por, duhet cekur se këto persona janë më të rrezikshëm për rrethin se personat që vuajnë nga skizofrenia dhe vuajnë dënimin apo janë të mbyllur në pavionet psikiatrike ngase nuk mund të dihet se kur mund të kryejnë krimin dhe kur duhet të mbrohet rrethi nga to.

Rast tjetër që e rëndon sistemin juridik në shqiptimin e veprave si dhe masave mbrojtëse psiqike, paraqiten edhe ato të sëmurë psiqik tek të cilët smundja shfaqet me ngadalësim.

Ato janë të vetëdijshëm për gjendjen e tyre dhe mund ta kontrollojnë të. Skizofrenët e tillë rrallë mund të diktohen, sepse kanë aftësi të punojnë etj. Megjithatë përsëri ekziston rreziku sepse ato aksplodojnë dhe e nxjerrin tërë atë që e kanë akumuluar me vite. Kur i sëmuri psiqik, kryen vepër penale, ato bëhen të përgjegjshëm vetëm atëherë kur nuk manifestojnë shenja të sëmundjes dhe këto persona i kuptojnë, e gjykojnë veprimet të cilat i kanë ndërmarrë. Kur bëhet fjalë për homicide e kryera nga skizofrenët ekziston një statistikë konfuze e cila varion nga vendi në vend. i sëmuri skizofren mund të kryejë krime të ndryshme. P.sh. të sulmojë personelin në pavionet psikiatrike, të kryejë vjedhje, vrasje, dhunime etj. Mirëpo më të shpështa janë vrasjet të cilat i kryejnë.

Një person skizofren nuk mund të kryejë krim vetëm nga smundja por aty ndikojnë edhe rrethi social, si dhe nga rrethana të tjera.

Mirëpo nga pasqyrimi klinik i përsëritjes së krimit nga ana e personave skizofren krimet janë më të lehta në fillim të paraqitjes së sëmundjes si dhe kah fundi i sëmundjes dmth pas marrjes së

terapisë, kurse në fazën e skizofrenisë së theksuar më të shpeshta janë vrasjet makabre. Këto persona vuajnë nga anksoziteti dhe në krimet që i kryejnë shfryejnë anksozitetin e akumuluar dhe nuk janë të kënaqur me egon e vet. Ato në çdo moment ndjejnë rrezik nga rrethi social, dhe nuk mund ta kontrollojnë veten e tyre dhe në fund rrugëdaljen e gjejnë në destruktivitet ku si pasojë logjike e sëmundjes së tyre dhe imagjinatës si dhe mbrojtje nga anksoziteti ato i kryejnë krimet.

Tek këto skizofrenë kemi ndërprerje të kontaktit me ambientin social, kontaktojnë vetëm me një pjesë së njerëzve dhe vetëshkatërrohen nga anksoziteti dhe frika , faktikisht këtu kemi të bëjmë fjalë me homicid patologjik.

Sa i përket përgjegjesisë penale tek të sëmurët skizofren çdoherë mendohet se ato janë të papërgjegjshëm, mirëpo sa i përket këtij mendimi kemi përjashtime ku kemi të sëmurë skizofren të cilët janë të përgjegjshëm për krimet e kryera. P.sh tek skizofrenia akute, kryesi ka kryer vepra penale vrasje për të cilën nuk përgjigjet penalisht , por veç vrasjes ka kryer edhe dhunë në familje gjë për të cilën është i përgjegjshëm penalisht. Prandaj me rëndësi është të analizohet dhe shqyrtohet motivi për secilën vepër që e ka kryer.

Tek personat të cilët gjatë kryerjes së krimit kanë qenë prezente të kutuarit e rëndësisë së veprës penale të cilën e ka kryer si dhe vetë gjykimit,do të jetë pjesërisht i përgjegjshëm.

Si zakonisht , viktimat tek të sëmurët psiçik janë të afërmit e tyre, por kur bëhet fjalë për bashkësi martesore si viktimat nga xhelozia i kemi bashkëshortin ose bashkëshorten.

Këtu na del një profilizim i qartë se as Kodi Penal i R.M e as as praktika gjyqsore nuk mbajnë llogari për personat në këto gjendje si dhe nuk ndërmarrin masa në raste të paraqitjes së dhunës së kryer nga po këto persona.

Këtu na ngelet vetëm të shpresojmë për përsime të mëtijshme, të organeve kompetente në lidhje me trajtimin e të sëmurëve skizofrenë.

Pasqyrim i disa rasteve :

I akuzuar T.D në datë 26.02.2015, në Kërçovë në ora 15.30, i punësuar në ambientin e MPB si

referent , në gjendje të pavetëdijshme përshkak të sëmundjes së përhershme të çrregullim shizofrenik , i ka sulmuar kolegët e tij të punës M.C dhe P.R duke u shkakuar lëndime trupore, gjatë orarit të punës, në të cilat ditë më parë I akuzuari ka paraqitur shenja agresiviteti dhe sjellje të pakëndshme.

Të lënduarit , gjatë dhënies së urdhërit të udhëheqësit e kanë thirrur të akuzuarin ta dërgojnë në zyrën e tij , por përderisa ia kanë kumtuar thirrjen duke e bindur.

Mirëpo i akuzuari papritur e ka goditur policing me iniciale M.C në pjesën e fytyrës , kurse policing P.R e ka goditur me grushta në pjesën abdominale , si pasojë e së cilës pas dhënies së rezistencës aktive me mjetet adekuate të akuzuarin e kanë mposhtur.

I akuzuari paraprakisht ka qenë në Spitalin Psikiatrik në repartin e psikozave të Demir Hisar, ku ka marrë terapi , deri ne 18.05.2014.

Mirëpo pas ndërprerjes së terapisë adekuate ku personi është konstatuar se vuan nga çrregullimi Shkizofrenik tregon se sëmundja i është paraqitur 5 vite më parë se të ndodhe dhuna.

Ai ka treguar shenja antisociale, i mbyllur ne vetëvete dhe në shtëpi, ka menduar se të gjithë flasin për të dhe dëshirojnë ti bëjnë diçka të këqe.

Përshkak këtyre problemeve ai Është mbajtur në Spitalin Psikiatrik të Demir Hisar dhe më pas është lëshuar në mjekim shtëpiak.

I akuzuari vetë ka ndërprerë marrjen e terapisë së caktuar nga psikiatri dhe ka filluar të paraqitet sërish sëmundja e cila ka sjell dhunën në vendin e punës.

Ditën para se të sulmojë policët i akuzuari ka filluar të bëjë rremujë në vendin e punës duke derdhur dokumentet dhe duke treguar shenja nervoze dhe agresivitet.

Interesante është se kur është sjellë në gjendjen normale ai ka deklaruar se nuk kujtohet në rastin i cili ka ndodhur dhe se I ka sulmuar kolegët e tij.

Pas këtij rasti të ndodhur, atë përsëri e kanë dërguar në Spitalin psikiatrik të Demir Hisarit sepse është përkeqsuar gjendja psiqike : i ëshë potencuar frika , pagjumsia poashtu, ka filluar ta akuzojë vetëveten për gjithçka, ka qenë i mbingarkuar psiqikisht dhe me mendime të ndryshme , shpesh ka biseduar me vetëveten,

Anamneza psiqike e të akuzuarit:

I akuzuari është i tensionuar emoconalisht, pandalje i zemruar për dikë ose për diçka, person i pa socializuar, lehtë rrezikon pa menduar pasojat, i padëgjueshëm, i eksponuar së tepërmi, ,

depreziv, dhe i frikësuar nga humbja e dikujt apo diçkaje të çmueshme për të. i determinuar dhe i mbyllur në vetëvete, dhe i pakënaqur nga jeta ,, me një fjalë person që jeton sot për nesër.

Ditën duke u debatuar G.E , ka sulmuar me dërrasë të gjatë 140cm shokun e tij G.J.

Më pas ka marrë gërshërët nga guzhina dhe e ka sulmuar po të njëjtin duke i shkaktuar gërvishje dhe lëndime të lehta trupore. E gjithë kjo ka ndodhur në shtëpinë e G.E. Shkaku ka qenë se G.E atë natë 03.03.2012, ka pasur zënkë me prindërit e tij, dhe kur i është thënë se ai është në gabim , ai fillon sulmimin ndaj shokut të tij. Ai është hutuar, dhe më pastaj del dhe në gjendje afektive fillon të thyej dritaret e veturës.

G.E paraprakisht ka qenë i hospitalizuar përshkak të skizofrenisë kronike dhe ka konsumuar terapi neuroleptike, mirëpo pas ndërprerjes dhe daljes nga Spitali i Bardovcit ai ka ndërprerë terapinë ku si pasojë ka filluar agresiviteti, idetë paranoide ndaj shokut të tij dhe gruas së shokut të tij, ka qenë i tensionuar, me kujtesë të shkurtër, shenja fobike, e tj.

Pas mbajtjes së seancës gjqsore G.E është shpallur i pafajshëm përshkak se ka vepruar në gjendje afektive , dhe gjithë atë vrull e ka nxjerrë mbi veturën e jo ndaj të tjerëve edhe pse ka mundur të ndodhë e kundërta.

Mirëpo, nga ekspertët neuropsikiatrik dhe psikiatrik është kërkuar që si masë mbrojtëse i akuzuari të dërgohet në spitalin psikiatrik ku do të vazhdojë me terapinë dhe mjekimin e vazhdueshëm.

K.N më datë 26.07.2009 ka sulmuar fqinjin e tij B.U në banesën e viktimës duke tentuar ta sulmojë me thike 10cm. Shkaku ka qenë se K.N ka menduar se fqinji i tij ia ka prerë kabllon e rrymës elektrike. Mirëpo , atë e ka ndaluar djali i B.U i cili ia ka marrë thikën dhe duke u vetëdijësuar K.N ka kuptuar se çka ka bërë dhe se faji nuk është i fqinjit të tij. Në momentin e vetëdijësimit ka ardhur edhe policia dhe e kanë arrestuar.

Pasqyra klinike e K.N tregon se K.N vuan nga skizofrenia, me epizoda paranoike dhe halucinacione, duke shprehur agresivitet, anksozitet dhe nervozizëm.

Në të dhënat psikiatrike është shënuar se K.N ka vuajtur nga episode akute psikotike dmth kemi të bëjmë me tempore criminalis. Dhe paraprakisht ka qenë i evidentuar në spitalin për sëmundje shpirtërore , në të cilin është diagnostifikuar me skizofreni.

Andaj edhe i akuzuari llogaritet si i papërgjegjshëm për veprën të cilën e ka kryer. Mirëpo nga anamneza e tij, ekspertët psikiatrik , sugjeronin që i akuzuari K.N të vazhdonte mjekimin në liri e cila nënkupton se i akuzuari duhet vazhdimisht secilin muaj të paraqitet në pavionin psikiatrik për kontrolle.

Duhet cekur se spektri i smundjeve të skizofrenisë është shumë i gjërë dhe nuk përfundun vetëm në këtë mënyrë.

Ja edhe 1 rast tjetër :

Nga të dhënat e gjykatës burojnë informacionet se i akuzuari S. nga Kërçova ka 24.09.2010 kryer vrasjen e i, me sopatë në kokë, e cila ka qenë nusja e djalit të tij. Vepra penale, kryesisht vrasja është kryer në shtëpinë ku kanë jetuar së bashku gjegjësisht në guzhinë.

Në vetngjarje nuk ka pasur dëshmitarë, mirëpo pas ekspertimit në vetëngjarje , ka pasur gjak të spikatur në mure, viktimë e shtrirë përtoke, dhe gjysë kofe e mbushur me gjak.

Nga dëshmitë e grumbulluara nga familjarët , rrjedh se gjaku ka qenë i fshirë nga dysHEMEJA ku ka qenë e shtrirë e ndjera. Dera e guzhinës ka qenë e dëmtuar nga ana e të akuzuarit, e thyer dhe e copëtuar.

Sipas të dhënave gjyqësore , dhe sipas kumtimit të F. e cila ka qenë në dhomën tjetër, motër e S. ka dëgjuar zërin nga gushina ku e ndjera I ka bërtitur nuk të kam bërë asgjë. Ajo tregonte se e ndjera në atë moment ka qenë duke gatuar drekë.

F. ka ikur nga ballkoni pasi që I. e ka paralajmëruar.

Storia e smundjes e evidentuar në Spitalin e Bardovcit ka datuar që para 10 viteve ku I akuzuari ka shfaqur halucinacione dhe shenja paranoike I cili ka menduar se e ndjekin njerëz, se po afrohet lufta, etj.

Familjarëve kjo u është dukur e dyshimt dhe çuditshëm. Ai natën nuk ka fjetur, tërë kohën ka qenë I heshtur, disaherë ka ngarendur duke menduar se dikush po e ndjek, mirëpo tërë këtë kohë nuk ka qenë agresiv përderisa e ka kapur nervoza.

Ka pasur momente kur ka menduar se për të flasin në telefon dhe nuk ka guxuar të dalë nga

shtëpija.

Tani pas kryerjes së vrasjes, është diagnostifikuar se vuan nga skizofrenia paranoid.

Megjithë parashkrimin e lartpërmendur, i akuzuari ka arritur të mbajë raportet me familjarët e ngushtë, këtu kanë pasur ndikim vëllezërit e tij dhe fëmijët e tij.

Nga na psiqike S. ka treguar se ka simptome të ndryshimi të sjelljes agresivitet, ka qenë në gjendje afektive, pa vullnet, dhe ndryshim të percepcioneve dhe vëmendjes.

Sipas këtyre të dhënave mundet të thuhet se nuk ka pasur motiv për kryerjen e vrasjes.

Dëshmitarët kryesisht familjarët si dhe i dëmtuari kanë deklaruar se i akuzuari kurrë nuk ka pasur konflikt me të ndjerën as para ditës kritike e as gjatë momentit kritik. Raportet midis tyre kanë qenë korrekte., andaj motivi duhet të kërkohet tjetër kund.

Ditën kur është kryer krimi duhet të theksohet se i akuzuari nuk ka qenë mirë : ka pasur kokëdhimbje, ka qenë i padisponuar, i zhytur në mendime etj.

Mënyra se si e ka kryer veprën penale në njëfarë mënyre e shpjegon motivin patologjik.

Në momentin kur ka kryer krimin ai ka pasur halucinacione dhe e tërë kjo ka qenë e shoqëruar me ansiozitet dhe frikë se po i ndodh diçka. Ndoshta atë moment ka pasur edhe halucinacione të cilat e kanë urdhëruar që ta kryej krimin që e ka kryer.

Nga kjo rrjedh se ai nuk ka qenë në vetëdije për veprimet të cilat i bën.

Veprimet që i ka ndërmarrë i akuzuari mund të arsyetohen përshkak të ndikimit të sëmundjes në të cilin ai është gjendur, andaj duhet cekur se S. konsiderohet i papërgjegjshëm për krimin e kryer ndaj të ndjerës i.

Edhe pse duhet të vazhdojë mjekim intenziv në Spital psikiatrik.

KREU IV

4. Analiza empirike dhe komparative mes shtetit të Illinois dhe Kërçovës

Faktorët që ndikojnë janë:

Vlerat Tradicionale (Gjakmarrja dhe hakmarrja)

Hulumtimi tregoi se Maqedonia është mjedis tradicional ose social konservativ.²⁷

Kjo është vërtetuar edhe me Pasqyrën e vlerave botërore, gjegjësisht në Maqedoni forcohen vlerat tradicionale.²⁸

Ekzistojnë dallime mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik, të cilët përsëriten mes të krishterëve nga tradita ortodokse dhe myslimanëve.²⁹

Edhe pse ekspertët janë të ndarë, shumica prej tyre konkludojnë se në Maqedoni ende ekziston hakmarrja .

Sipas politikologes Prof. Dr. Biljana Vankovska , profesoreshë në Universitetin Kiril dhe Metodij , Shkup e cila cek se incidentet multietnike krijojnë tensione më të mëdha andaj vehtet në pyetje një çështje kriminalistike e degës së sigurimit të rendit publik

Numri errët statistikisht tregon se në Kërcevë ende ekziston numri I errët I vrasjeve të cilat bëhen përshkak të gjakmarrjes.

Nuk duhet anashkuar edhe rast i I.B, I cili vuante nga skizofrenia paranoike, e i cili ishte në zënkë me personin A.A, dhe shkak i hakmarrjes ,më 02.02.2014 ai përderisa priste që të gjuante më armë personin A.A i cili supozohej të ishte ne motor, me veshjen speciale , në të ndodhej një shtetas i amerikës, SH.A poashtu bashkëqytetar I tyre.

Personi I.B zbrazti revolen mbi trupin e SH.A. duke menduar se ishte A.A

Faktorët që ndikuan në gabimin e vrasjes ishin: ishte natën dhe ishte i veshur me tesha motoçiklisti SH.A.

I.B e dënuan me 7 vite burg , shkak i gjendjes së sëmurë psikike , mirëpo pasi Sh.A. ishte shtetas i Amerikës intervenuan FBI që dënimi tw rritej deri në 14vjet burg.

Duhet cekur se në Maqedoni është formuar Shoqata për pajtimin e gjaqeve, e cila funksionon edhe në Kosovë dhe Shqipëri por që duhet cekur se i tërë procesi i zgjedhjes është i komplikuar.

²⁷ Qëndrimi ndaj vlerave tradicionale/sekulare, Sasho Klekovski, 2009, Makedonski Centar za Sorabotka- Artikull

²⁸ Po aty

²⁹ Po aty

Atributet kurtulogjike (jetë në vende të vogla)

Shohim se vendet e zhvilluara industrialisht i kushtojnë një kujdes të madh parandalimit të kriminalitetit në nivelin lokal duke u nisur nga supozimi se fjala është për interesin primar të mbrojtës së sigurisë së njerëzve dhe të pasurisë në fazën ante delictum, përkatësisht në paradhomën e deliktit. Me këto aktivitete ngritet me të madhe vetëdija e qytetarëve mbi obligimin për bashkëpunim me zyrtarë për zbatimin e ligjit dhe natyrisht, si edhe vetë besimi në aparatën komplet shtetëror. Në vazhdim do t'i pasqyrojmë direktivat e caktuara të Këshillit të Evropës që i kushton një kujdes të madh këtij problemi.³⁰

Direktivat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Koncepti i organizimit institucional të parandalimit të kriminalitetit është ngritur edhe në nivel ndërkombëtar. Pra, në kuadër të Këshillit të Evropës (Council of Europe – CE), është formuar(Organizata për parandalimin e kriminalitetit që të themelojnë, stimulojnë dhe përkrahin agjencionet për parandalimin e kriminalitetit në nivel nacional, regjional dhe lokal. (Schëind, 1998: fq. 343-357). Inkorporimi i sistemit të veprimtarisë policore, i orientuar në parandalimin e kriminalitetit në nivel të bashkësisë lokale konsiderohet si kusht obligues i të ashtuquajturave proceseve integruese Amerikane. Pikërisht për shkak të këtyre fakteve do t'i prezantojmë disa nga rekomandimet e Direktivave të SHBA-së që janë proklamuar nga fundi i vitit 2002 e lidhur me rekomandimet e dedikuara pushteteve lokale të vendeve në tranzicion me qëllim të parandalimit të kriminalitetit në qendrat e tyre urbane dhe rurale. Kriminaliteti, si ndjenjë e (pa)sigurisë në përgjithësi, është çështje vijuese e shoqërive moderne në Evropë dhe më gjerë. Pra, ai me siguri është arsye e përditshme për brengë dhe objekt parësor i shumë hulumtimeve shkencore dhe i formave të ndryshme të diskutimeve. Në rastin e elaborimit dhe të evaluimit të problemit të cekur zhvillohen konkluzione unike që rezultojnë me rekomandime, sipas të cilave pushtetet lokale duhet të bartin barrën kryesore në parandalimin e kriminalitetit. Kriminaliteti ndikon negativisht në një përqindje të madhe të popullsisë. Ai tërheq pas veti shumë deviacione të tjera: shpenzimet e larta shoqërore dhe ekonomike; shkakton humbje, lëndime dhe vuajtje emocionale të viktimave dhe të familjeve të tyre; zvogëlon aftësinë e qytetarëve që t'i gëzojnë përparësitë e stabilitetit material;

³⁰ Elmedin Muratbegović, Parandalimi I Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control) , fq 106, Sarajevë/ Prishtinë , 2007

zvogëlon besimin e opinionit në proceset demokratike; stimulon lëvizjet ekstremiste; paraqet kërcënim për të drejtat e njeriut dhe institucionet demokratike; provokon frikën dhe pasigurinë e tepruar; dhe çka është edhe më e keqe, nevojën për hakmarrje ose për konflikte ndër etnike. Pikërisht për shkak të këtyre fakteve, kriminaliteti paraqet kërcënim për demokracinë në përgjithësi sepse nxitë impulse raciste dhe “mbrojtëse”, dhe vepron si ftesë për forma “të thjeshtëzuara” të drejtësisë tek të cilat nuk i kushtohet vëmendja respektimit të lirive dhe të dinjitetit të njeriut. Me rastin e luftimit të të ashtuquajturit “kriminalitetit urban” është e domosdoshme të merret në konsiderim edhe e drejta në privatësi, dhe shkeljet e mundshme të saj. Si shembull mund të shërbejnë sistemet e mbyllura televizive (TV kabllovik) shfrytëzimi i të cilave njihet si mjet legjitim për pengimin e kriminalitetit, e prapë është kontravers nga aspekti i të drejtës në privatësi.³¹

Në mënyrë që në luftë kundër kërcënimeve të përmendura më lartë qytetarëve t’ju sigurohet ndjenja e sigurisë, por edhe siguria reale, është e rëndësishme që pushteti në nivelin shtetëror, regjional dhe lokal të pranojë që liria nuk është e mundur pa siguri. E drejta në jetë në rrethinën e sigurt do të duhej të ishte e drejta themelore e njeriut. Pushteti duhet të kujdeset që të sigurojë që kontrollit të kriminalitetit t’i japin përparësi dhe për këtë të sigurohen resurset adekuate dhe të pranohet parandalimi i kriminalitetit si model i përhershëm i aktivitetit. Parandalimi nuk është vetëm më i lirë se represioni, por është qasje ku dinjitetit të njeriut i jepet rëndësia më e madhe e mundshme. Detyra e pushtetit lokal të një bashkësie duhet të jetë edhe sigurimi i ndjenjës së përkatësisë së bashkësisë qytetare tek popullata e gjithëmbarshme, dhe që qytetarët përveç asaj që i gëzojnë të drejtat e caktuara, gjithashtu të pranojnë edhe përgjegjësitë koresponduese (Vis-à-vis) të respektimit të integritetit dhe të paqes shpirtërore të pjesëtarëve të tjerë të bashkësisë. Deri sa qeveria qendrore ka obligim të qartë për vendosjen e kornizës juridike për parandalimin e kriminalitetit dhe të represionit, si dhe për sigurimin e resurseve adekuate financiare dhe të udhëheqjes politike, problemi i nivelit lokal është diçka krejtësisht tjetër. Pra, brenda këtij mjedisi ndjenja e pasigurisë përjetohet në mënyrë permanente dhe për çdo ditë. Si pasojë e raporteve të këtilla, pushtetet lokale janë më të aftat për zbatimin e politikës së parandalimit gjithëpërfshirës të kriminalitetit. Brenda saj promovohen: alternativat e mbylljes së kundërvajtësve, funksionet policore në bashkësi, lufta kundër analfabetizmit, arsimimi shoqëror,

^{31 31} Elmedin Muratbegović, Parandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control) , fq 107, Sarajevë/ Prishtinë , 2007

hulumtimi dhe komunikimi, si dhe koordinimi i programeve të shumta nga ana e shumë partnerëve. Duke pasur parasysh se janë direkt në kontakt me ta, qytetarët e organeve komunale të pushtetit konsiderohen si më të përshtatshmit dhe më së miri të informuar mbi situatat potenciale ose situatat ekzistuese të krizës. Pushteti lokal gjithashtu mund të punojë në qetësimin e situatës dhe të marrë rolin e ndërmjetësuesit, dhe me këtë të ndikojë në zvogëlimin e tensioneve dhe të sigurojë që angazhimi i policisë dhe i gjykatave të mos jetë i domosdoshëm. Pushteti lokal gjithashtu ka edhe rolin prijës indirekt, me faktin që ndikon në formimin e politikës së një varg sektorësh në kompetencën e tyre, në mënyrë që të sigurohet trajtimi adekuat i çështjeve të sigurisë. Si pasojë e kësaj, nga pushteti qendror shtetëror pritet që në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin lokal, të pranojë që politikat lokale për reduktimin e kriminalitetit dhe të pasigurisë urbane janë elemente kyçe të programit për reduktimin e kriminalitetit.

Problemet ekzistenciale

Shohim se vendet e zhvilluara industrialisht i kushtojnë një kujdes të madh parandalimit të kriminalitetit në nivelin lokal duke u nisur nga supozimi se fjala është për interesin primar të mbrojtës së sigurisë së njerëzve dhe të pasurisë në fazën ante delictum, përkatësisht në paradhomën e deliktit. Me këto aktivitete ngritet me të madhe vetëdija e qytetarëve mbi obligimin për bashkëpunim me zyrtarë për zbatimin e ligjit dhe natyrisht, si edhe vetë besimi në aparatit komplet shtetëror.³²

Dallimi qëndron se në vendet në tranzicion sic gjendet Republika e Maqedonisë , ende përballemi me krizë të rëndë ekonomike, e cila ndikon tek qytetarët që të kryejn krime nga vjedhjet e deri tek krimet më të rënda, ndikon poashtu edhe në shendetin e tyre, behen anksiozë, depresiv, etj.

Duhet cekur se ende ekziston stigma për vajtje në psikiatër dhe bashkpunim me to në lidhje me problemet dhe smundjet që i vuajnë.

Në Maqedoni ende kemi mungesë të shërbimeve që do i kontrollojnë : dhunën në familje, kontroll I konsumimit të rregullt të terapisë , të të sëmurëve psiqik.

³² ³² Elmedin Muratbegović, Parandalimi I Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control) , fq 106, Sarajevë/ Prishtinë , 2007

Illinois ka mjaft histori unike kur bëhet fjalë për raste të veprave penale. Ka qenë vendi për disa nga krimet më famëkeqe të kombit të kryera nga individë apo persona me çrregullime mentale. Për shkak të vrasjeve massive she dhunës nga individët me çrregullime mentale, shteti i Illinois u përballë me shtyp të keq në juridiksionin Brenda shtetit.

Shkalla e krimit të kryer nga individët me çrregullime mentale përcaktohet si numri i përgjithshëm krimeve të ndryshme dhe llogaritet si më poshtë:

Në vitin 2015, shkalla e arrestimit për përdhunim në Illinois ishte 29,1%. Mesatarja kombëtare ishte 9.1%.

Vrasja ishte 5,0 % në vitin 2015, në krahasim me mesataren kombëtare prej 120%.

Nga viti 2009 e deri në vitin 2015 çfarëdo lloj krimi në Illinois të kryer nga persona me çrregullime mentale është në rritje në krahasim me qytetin e Kërçovës.

Deri më sot, asnjë vrasës serik nuk ka mbajtur një pishtar të shtetit të Illinois kur është fjala për çmendurin dhe sofistikimin e tyre.


Në qytetin e Kërçovës krimet e ndryshme të kryera nga kriminelë me çrregullime mendore variojnë më ngryshe se sa në shtetin e Illinois , varësisht nga numri i vogël i popullatës.

Duhet patur parasysh se edhe në Kërçovë, në këtë qytet të vogël në përgjithsi krime që janë kryer nga persona me çrregullime mentale është 0.015 % në nivel kombëtarë, duke përfshirë nga prishje të rendit publik e deri në vrasjet makabre e serike të ndodhura po në këtë qytet.

Vitet	Vrasje	Vjedhje	Prishje të rendit publik	Gjithsej	Në %
2009	*	1	2	3	0.005 %
2010	1	1	*	2	0.003 %
2011	*	*	*	0	0 %
2012	*	*	1	1	0.0017 %
2013	1	*	*	1	0.0017%

2014	1	*	*	1	0.0017 %
2015	*	*	1	1	0.0017%
Gjithsej	3	2	4	9	0.015 %

Prej 3 llojeve të krimeve në përgjithsi në krahasim me shtetin e Illinois demonstrimi bëhet me anë të tabelës si vijon:



Përshkak të mirëkuptimit moral , një numër teoricientësh mendojnë se personat me çrregullime mentale duhet të lirohen nga përgjegjsia penale në shtetin e Illinois përshkak të paaftësisë për të ndijerë.

Poashtu ato kanë argumentuar se është e vështirë të dallosh një individ me çrregullime mentale kur kryen krimin me një kriminel tipik.

Përqëndrimi në provat empirike sugjerojnë se disa psikopatë, në fakt, duket se kanë deficite që i dallojnë ata nga shkelësit përgjegjës. Këto mangësi duket se minojnë aftësinë e psikopatëve për të kuptuar moralin.

Pasqyrimi i tabelës së krimeve në shtetin e Illinois:

VITET	VRASJE		VJEDHJE		PËRDHUNIME	
2009	15,399	5.0 %	408,742	133,1%	89,241	29,1%
2010	14,722	4,8 %	369,089	119,3%	85,593	27,7%
2011	354,746	113,9%	354,746	113,9%	84,175	27,0%
2012	14,856	4,7 %	355,051	113,1%	85,141	27,1%
2013	14,319	4,5 %	345,093	109,0%	82,109	25,9%
2014	14,164	4,4 %	322,905	101,3%	84,864	26,6%
2015	15,696	4,9 %	327,374	101,9%	90,185	28,1%

PËRFUNDIMI :

. Kjo temë trajton format tradicionale të vlerësimit të paaftësive mendore, të tilla si intervistat dhe testimet njohëse, si dhe duke marrë parasysh përgjigjet autonome dhe provat neuroshkencore. Ajo argumenton se skanimet e trurit dhe testimi autonom nuk mund të zëvendësojnë forma të tjera të vlerësimit, siç janë intervistat dhe testimet kognitive. Megjithatë, të dhënat fiziologjike dhe nervore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me të dhënat nga burime të tjera. Është paraqitur se këto teknika janë mjaft premtuese që të garantojnë vendosjen e provave të testeve të tilla para një jurie dhe duke lejuar jurinë të vendosë nëse në ndonjë rast të

veçantë është vendosur mosrespektimi mendor i një personi me psikopati.³³



Literatura e shfrytëzuar:

Patients with Schizophrenia and Self-Care , Slavica Arsova, Stojan Bajraktarov, Kadri Haxdzihamza 2014, Journal of Medical Sciences Artikull

Some QEEG parameters and gender differences in schizophrenia patients. Nensi Manuseva, Antoni Novotni, Stojan Bajraktarov, Beti Zafirova -Iva-ovska, 2012 Psychiatria Danubina- Artikull

Persobality Characteristics as Predictive Factors for the Occurrence of Depressive Disorder, Stojan Bajraktarov, Dance Gudeva- Nikovska, Nensi Manuseva Slavica Arsova, 2017 Journal of Medical Sciences – Artikull

Character and Temperament Dimensions in Subjects with Depressive Disorder: Impact of the

³³ European Journal of Current Legal Issues, Vol.22, No. 2, Author: Elizabeth Shaw, 2016

Affective State on their Expression. Stojan Bajraktarov, Slavica Arsova, Antoni Novotni, Dance Gudeva- Nikovska, Viktorija Vujovik, Journal of Medical Sciences , 2017 – Artikull

Kriminalistika Mjekësore, Alija Ramljak, Sarajevë/Prishtinë, 2007

Metodika Kriminalistike (deliktet e gjakut, seksuale, pasurore), Doc. Dr. Nedzat Korajlic, Sarajevë/Prishtinë, 2007

Psihijatrija, Nikola Persie ,1969, Ljubjana

Psiholoski profil ubojce u 6 tipicnih znacajki,, 2019- Artikull

Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011

Kriminalistika, Vesel Latifi, Prishtinë, 1999

Dusevne Bolesti, P. Milekic, Beograd/Zagreb, 1968

Nove Dusevne Bolesti, Julija Kristeva, Paris, 1997

Psihoza, shizofrenija, shizoafektivni poremecaj, Sladana Strkalj, Hrvatska, 2011

Ja , Psihologija i Psihoze, Pol Federn, Beograd, 2002

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

Psihoze, Vlado Jukic, Zagreb, 1993

E Drejta Penale (Pjesa e pergjithshme), Vllado Kambovski, 2005

Bihejvior terapija vo tretmanot na fobicno-anksiozni sostojbi. Dr. Vitoir Micev, Ana Kiprovska, Zlatko Petrov, 1981- Artikull

Stravot: Niz Dnevnikot na eden psihijatar, Vitomir Micev, Skopje, 1979

Ligji i Sanksioneve Penale i Republikës së Maqedonisë :
Neni 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 246, 247, 248, 249, 250

Bashkpunim dhe të dhëna nga Gjykata Themelore Kërçovë,

Bashkëpunim dhe të dhëna nga Burgu i Demir Hisarit

Bashkëpunim me Spitalin Psikiatrik të Bardovcit

Bashkëpunim me Dr.Elizabet Miceva Velickoska, D-r. sci , Psihijatar

Daniel Cvijic , I pojam I predmet Kriminologije – Arikull

Drita Shala, Kriminologjia, Desertacion , Prishtinë ,2014

Psikopatologjia Gjyqësore, Sllobodan Lloga , Prishtinë, 2007

Biological Factors and Crime: Implications for Forensic Psychiatry, Mednick SA, Finello KN, 1983- Artikull

Biological Factors in Crime, Keith E. Rice, 2016 – Artikull

Ubistvata vo Makedonija, Dr.Zoran Sulejmanov, 2015

Police Psychics: Do They Really Solve Crimes?Joe Nickell, 2004 - Artikull

Understanding Psychopathic Criminals, Scott. A. Bonn, Ph.D, 2016 - Artikull

Psychopathy, Moral Understanding And Crime Responsibility, Elizabeth Shaw, 2016 –Artikull

Traumatic Experiences in Childhood and Psychopathy: A study sample of violent offenders from Italy, Giuseppe Craparo, Adriano Schimmenti, Vincenzo Caretti, 2013- Artikull

Genetic and Environmental Influences on Criminal Behavior,Caitlin M. Jones

Rochester Institute of Technology, 2005

THE CRIMINAL PSYCHOPATH: HISTORY, NEUROSCIENCE, TREATMENT, AND ECONOMICS, Kent A. Kiehl, Morris B. Hoffman, 2011

Personality correlates of criminals: A comparative study between normal controls and criminals

Sudhinta Sinha, 2016 – Artikull

Clarifying the relationship between temperament and antisocial behavior Megan Lenferink
Tilburg University, - Desertacion

On Character: Essays , James Q. Willson, 1995

Temperament, character, and personality disorders: etiologic, diagnostic, treatment issues, D.M Svrakic, S.Draganic, K.Hill, C. Bayon, T.R. Przybeck, C.R.Cloninger, 2002- Artikull

Borderline Personality and Criminality, Randy A. Sansone, MD and Lori A. Sansone, MD, 2009- Artikull

Violent crimes and their relationship to personality disorders, MICHAEL H. STONE, Published online in Wiley InterScience, 2007

The 10 Personality Disorders, Neel Burton M.D, 2012 - Artikull

Drejtësia Restorative, Mr. Sc. Azra Adzajlic-Dedovic, Sarajevë/ Prishtinë, 2007, Desertacion

Theories of Crime and Punishment, By Dr. Claire Grant, Claire Valier

Violence, Crime, and Psychopathic Offenders, Jennifer Chase, 2011- Artikull

Only Yesterday: The Rise and Fall of Twentieth Century Sexual Psychopath Laws, Tamara Rice Lave, 2009- Desetacion

Forever a Psychopath? Psychopathy and the Criminal Career Trajectory, Julia Shaw Stephan Porter, 2012

Sutherland, Cleckley and Beyond: White-Collar Crime and Psychopathy Frank S. Perri , Terrance G. Lichtenwald & Edyta M. Mieczkowska, International Journal of Psychological Studies, 2014

PAPËRGJEGJSHMËRIA PËR SHKAK TË GJENDJES MENDORE. KRITERI JURIDIK NË TË DREJTËN PENALE, Kreshnik Myftari, Tiranë, 2014 - Desertacion

Neurozat rrezikojnë tipat e ndjeshëm, Revista Shekulli, 2012

The Relationship Between Violence and Psychotic Disorders, Fredric Neuman M.D, 2014- Artikull

Counseling Criminal Justice Offenders, By Ruth E. Masters, 2004

Criminal conviction, impulsivity, and course of illness in bipolar disorder

Alan C Swann, Marijn Lijffijt, Scott D Lane, Kimberly J Kjome, Joel L Steinberg, and F Gerard Moeller, 2011- Artikull

Handbook of Psychiatry: Volume 4, The Neuroses and Personality Disorders edited by Gerald F. M. Russell, Michael Shepherd, Lionel Hersov, 1983

The psychopath: Facts and research resources, Dr. Jez Phillips, 2012- Artikull

The Relation between Crime and Psychopathic Personality Nathaniel Thornton, 1951- Artikull

Во Македонија се' уште постои крвна одмазда, Daily Macedonia, 2012- Artikull

Qëndrimi ndaj vlerave tradicionale/sekulare Saso Klekovski, 2009- Artikull

Parandalimi I Kriminalitetit, Elmedin Muratbegovic, Sarajevë / Prishtinë, prill 2007- Desertacion

\